

*Gjinia në TV në vitin 2018:  
Pas ekranit dhe në të*



## Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrja.....	1
Pas ekranit.....	3
Struktura gjinore e të punësuarve në gjithë industrinë televizive .....	5
Struktura gjinore e të punësuarve në televizionet nacionale.....	10
Konkluzion.....	14
Në ekranin.....	16
Televizioni i Maqedonisë – Servisi i parë programor i Servisit radiodifuziv publik.....	21
Televizioni i Maqedonisë - Servisi i dytë programor – Programi në gjuhën shqipe.....	26
TV Alsat-M.....	31
TV Alfa .....	35
TV Kanal 5.....	40
TV Sitel .....	48
TV Telma .....	55
Rekomandimet:.....	65
Biografite e autorëve/autoreve: .....	66



## Hyrja

Duke e ndjekur obligimin e vet nga „Ligji për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve” nga viti 2012, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale edhe në vitin 2018 realizoi hulumtime për çështjet gjinore dhe për mënyrën e paraqitjes dhe përfaqësimit të meshkujve dhe femrave në konceptet programore dhe përmbajtjet e mjeteve për informim publik. Përveç kësaj, në pajtim me praktikën e vet shumëvjeçare, trupi rregullator siguroi edhe të dhëna për strukturën gjinore të të punësuarve në radiot dhe televizionet, ndërsa nga regjistrat e radiove dhe televizioneve<sup>1</sup> rregullisht mund të merren informatat e përditësuara për strukturën pronësore të radiodifuzerëve, që nënkupton edhe informata për përfaqësimin e femrave dhe meshkujve në pronësinë.

Gjithë këto janë indikatorë përmes të cilave në këtë publikim është paraqitur gjendja me përfaqësimin e gjinisë dhe temat gjinore në ekranet, por edhe pas tyre, te personat përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e politikës redaktuese të mediave. Nevoja për prezantimin e tillë të fotografisë së përgjithshme është e qartë nëse kihet parasysh Rekomandimi i Këshillit të Evropës nga viti 2017 për barazinë gjinore në sektorin audiovizual, në të cilin është theksuar se:

*„Sektori audiovizual u shërben të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Kjo kërkon që t'i kushtohet vëmendje veçanërisht barazisë gjinore edhe në aspekt të pjesëmarrjes dhe qasjes në sektorin, edhe në aspekt të përmbajtjeve dhe mënyrës në të cilën femrat trajtohen dhe përfaqësohen...”<sup>2</sup>.*

---

<sup>1</sup> Regjistrat janë të disponueshme në: <http://avmu.mk/radiodifuzeri-mk/>

<sup>2</sup> Rekomandimi KM/Rec(2017)9 i Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës drejtur shteteve anëtare për barazi gjinore sektorin audiovizual të disponueshëm në gjuhën maqedonase në: [avmu.mk/wp-content/uploads/2017/12/Recommendation-CM-Rec20179-MAKEDONSKI.docx](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/12/Recommendation-CM-Rec20179-MAKEDONSKI.docx)

Që këtu, publikimi, në pjesën e parë e tregon gjendjen me pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve pas ekranit, dhe atë në të gjitha nivelet, nga pronarët e deri te kuadri ndihmës, me ç'rast të dhënat e reja ndërlihen me ato për periudhën 2012-2016 të cilat janë publikuar në "Gjinia në televizion: Përmbledhja e hulumtimeve vjetore për trajtimin e çështjeve gjinore dhe për mënyrën e prezantimit të femrave dhe meshkujve në stacionet televizive nacionale (2012-2016) - me indikatorë krahasimtarë"<sup>3</sup> (më tutje në tekstin „Gjinia e televizionit...“) e publikuar në fillim të vitit 2018. Në pjesën e dytë janë paraqitur rezultatet nga analiza e programit televiziv në aspekt të prezencës dhe trajtimit të temave relevante gjinore dhe në aspekt të paraqitjes dhe përfaqësimit të meshkujve dhe femrave, por kësaj here të realizuara mbi një ekzemplar tjetër të emisioneve. Gjegjesisht, gjashtë vite, ekzemplarë ishin lajmet dhe reklamat e televizioneve nacionale, nga të cilat doli edhe publikimi në të cilin përmes krahasimit të indikatorëve nga viti 2012 deri në vitin 2016 u treguan edhe trendët në shpeshimin dhe trajtimin e temave gjinore në programet dhe në mënyrën në të cilën janë përfaqësuar femrat dhe meshkujt në TV në shtet.

Në vitin 2018, dukej se është koha, në vend që edhe njëherë të përsëriten hulumtimet, të shihet edhe në emisionet tjera, dhe prandaj janë analizuar emisionet e mëngjesit/drekës në shtatë TV serviset të cilat janë rregullisht lëndë e analizës: servisi i parë dhe i dytë programor televiziv i Servisit radiodifuziv publik – RTM1 dhe RTM2 – Programi në gjuhën shqipe, dhe televizionet terestriale komerciale në nivel shtetëror: Alsat – M, Alfa, Kanal 5, Sitel dhe Telma. Gjatë analizës së përmbajtjes u shfrytëzua pyetësor i veçantë, i përgatitur në bazë të instrumenteve të cilat u shfrytëzuan në gjashtë vitet paraprake. Analizën e realizoi ekipi hulumtues nga Sektori për punë programore të Agjencisë dhe atë: mr. Emilija Petreska-Kamenjarova, Marina Trajkova, mr. Viktor Stojanov, mr. Teodora Ristovska dhe Nestrin Mahmut.

---

<sup>3</sup> „Gjinia në televizionin: Përmbledhje të hulumtimeve vjetore për trajtimin e çështjeve gjinore dh për mënyrën e prezantimit të femrave dhe meshkujve në TV stacionet nacionale (2012-2016) – me indikatorë krahasues“, të disponueshëm në: <https://bit.ly/2QdEDOD>

## Pas ekranit

Sigurimi, analiza dhe publikimi i të dhënave të ndarë gjinore për aspekte të ndryshme të industrisë mediatike audiovizuale është një prej drejtimeve nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës për barazinë gjinore në sektorin audiovizual. Kjo shihet si faktor i rëndësishëm në mbledhjen e indikatorëve fotografikë për sferat dhe nivelet e (pa) barazisë ndërmjet meshkujve dhe femrave në këtë sferë. Të dhënat e publikuara këtu e pasqyrojnë gjendjen e strukturës gjinore të pronësia dhe të të punësuarit.

Nga regjistrat e radiove dhe televizioneve në çdo moment mund të konstatohet çfarë është përfaqësimi i femrave dhe meshkujve në strukturën e pronësisë<sup>4</sup>. Prandaj, krahasimi të kjo kategori është bërë kështu që janë shfrytëzuar të dhënat nga fillimi i dhjetorit 2018 dhe ato të dhjetorit në vitin 2017, të cilat janë publikuar në "Gjinia në televizionet..." Sipas këtyre të dhënave, nga 53 televizione komerciale, 13 janë në pronësi të personave juridikë, 36 janë në pronësi të personave fizikë, ndërsa të 4 pronësia është kombinim i personave juridikë dhe fizikë. Struktura gjinore mund të analizohet të ato media që janë pjesërisht ose tërësisht në posedim të personave fizikë, përkatësisht të 40 televizioneve, me ç'rast gjendja është si vijon:

- Në pronësinë e 29 televizioneve figurojnë vetëm meshkuj (100%), që është për pesë më pak sesa viti paraprak kur si njëqind përqind pronarë meshkujt janë paraqitur të 34 televizioneve.

- Vetëm të ato tre TV stacionet femrat paraqiten si pronare me 100%, gjë që është rënie për një krahasuar me vitin paraprak.

- Te katër shtëpitë tjera televizive, pronësia përbëhet nga meshkuj dhe femra, me ç'rast pjesëmarrjet e femrave në pronësinë ndryshojnë - 10%, 33%, 50% dhe 66,7% (nuk ka ndryshim krahasuar me dhjetorin 2017).

- Te tre prej televizioneve pronësia është kombinim i personave juridikë dhe fizikë. Në dy prej tyre, bashkë me personin juridik paraqitet edhe pronari (nuk ka ndryshim). Në një TV shtëpi paraqitet

---

<sup>4</sup> Regjistrat janë të disponueshme në: <http://avmu.mk/radiodifuzeri-mk/>

kombinimi nga person juridik dhe pronare, me ç'rast femra posedon 48% të pronësisë, ndërsa personi juridik – 52% dhe kjo është gjendje e re në krahasim me muajin dhjetor të vitit 2017, kur nuk ishte konstatuar kombinimi i tillë në pronësinë.

- Te një media, pronësia është kombinim i personit juridik, mashkull dhe femër, me atë që mashkulli dhe femra posedojnë nga 0.07% ndërsa personi juridik 99,86%. Kjo është edhe media e vetme nacionale të e cila në pronësinë paraqitet femra (nuk ka ndryshim).

Përveç kësaj, Agjencia tanimë një periudhë më të gjatë kohore mbledh dhe publikon të dhëna të ndara gjinore për të punësuarit në radion dhe televizionet, ndërsa në vitin 2017<sup>5</sup> publikoi analizë e cila i tregoi trendët – përkatësisht ngritjet dhe rëniet në hendekun gjinor në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2016<sup>6</sup>. Analizat për strukturën e të punësuarve përpunohen pas përfundimit të vitit, kështu që në vitin 2018, janë përpunuar të dhënat për vitin 2017. Në krahasimin që është dhënë këtu, janë shfrytëzuar të dhënat për periudhën 2012-2016 kështu që mund të shihen trendët për një periudhë më të gjatë kohore megjithëse theksi është vendosur në lëvizjen e vendeve të punës ndërmjet vitit 2016 dhe 2017.

Krahasuar me të dhënat nga viti 2016, në vitin 2017 vërehet rënie në numrin e të punësuarve në gjithë industrinë televizive. Siç është theksuar në analizën e Agjencisë për Strukturën e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2017<sup>7</sup>, rënia është më e madhe te televizionet komerciale. Gjegjësisht, numri i përgjithshëm i të punësuarve në TV stacionet private është zvogëluar për 225, mbi të cilin ndikim të konsiderueshëm ka pasur edhe fakti që në këtë vit pushuan së punuari 8 televizione. Në to, një vit para kësaj ka pasur 194 të punësuar. Përveç kësaj, në Servisin radiodifuziv publik si

---

<sup>5</sup>Analizat e strukturës së të punësuarve janë të disponueshme në: <https://bit.ly/2rPd27G>

<sup>6</sup>„Gjinia në televizionin: Përmbledhje e hulumtimeve vjetore për trajtimin e çështjeve gjinore dhe mënyrën e prezantimit të femrave dhe meshkujve në TV stacionet nacionale (2012-2016) – me indikatorë krahasimtarë“, të disponueshëm në: <https://bit.ly/2QdEDOD>


<sup>7</sup> Disponueshëm në: <https://bit.ly/2ScUAS2> faq 4.



tërësi (edhe radioja edhe TV-ja) në vitin 2017 ka 19 të punësuar më pak sesa në vitin 2016.


### Struktura gjinore e të punësuarve në gjithë industrinë televizive

Ajo që mund të konstatohet kur do të shihen të dhënat për atë sesa është numri i femrave dhe meshkujve të punësuar në industrinë televizive në tërësi dhe në cilat pozita gjenden – është se nuk ka ndryshime drastike në konstatimet kryesore. Femrat edhe më tutje janë pak të përfaqësuara ndërmjet drejtuesve/seve dhe drejtorëve/eshave (Fotografia 1). Numri i përgjithshëm i të punësuarve në këto pozita në vitin 2017 është zvogëluar për 8 persona (gjë që korrespondon me numrin e televizioneve që kanë pushuar së punuari). Dy prej këtyre personave janë femra, ndërsa gjashtë janë meshkuj.




Në vitin 2017, numri i drejtuesve/seve është zvogëluar për 10, me ç'rast rënia është e barabartë – pesë meshkuj dhe pesë femra (Fotografia 2).

Foto 2: Numri i redaktoreve dhe redaktorëve ne te gjitha TV




Zvogëlim më të madh ka te gazetarët/et - ato janë për 95 më pak, nga të cilat 57 femra, 38 meshkuj. Megjithatë, gazetaria edhe më tutje mbetet profesion i femrës (siç mund të shihet në Fotografinë 3, ka gjithsej 116 femra më shumë sesa meshkuj), përkatësisht kjo mbetet të jetë shkalla e parë në të cilën ka më shumë femra sesa meshkuj, por njëkohësisht është edhe shkallë e cila është e orientuar në zbatimin e politikave tanimë të përcaktuara redaktuese.

Foto 3: Numri i gazetareve dhe gazetarëve ne TV




Marketingu është pozita e vetme në të cilën, shikuar në përgjithësi, në vitin 2017 në vend të rënies shënohet rritje të të punësuarve nga gjithsej tetë persona (Fotografia 4). Shikuar sipas gjinisë situata është diçka më ndryshe sepse pjesëmarrja e meshkujve është rritur për dhjetë, ndërsa te femrat është zvogëluar për dy dhe kështu për herë të parë nga viti 2012 në marketingun janë punësuar më shumë meshkuj sesa femra.

Foto 4: Numri i te punesuarve ne marketing ne te gjitha TV




Te kuadri teknik (inxhinierë/e dhe teknikë/e, meshkujt edhe më tutje e përbëjnë pjesën dominuese nga të punësuarit, përkatësisht ka 160 meshkuj më shumë (Fotografia 5). Përgjithësisht, numri i të punësuarve në këtë kategori është zvogëluar në lidhje me vitin 2016 për 25 nga të cilat 11 femra dhe 14 meshkuj.




Edhe një kategori e punonjësve e cila mbetet kryesisht kategori meshkujsh, është kuadri i realizuesve (Fotografia 6). Numri i meshkujve të punësuar si regjisorë, incizues, montues etj, është zvogëluar për 65, gjë që është për shtatë herë më shumë sesa që është zvogëluar numri i femrave (nëntë), por megjithatë kjo kategori e të punësuarve ka 458 meshkuj më shumë sesa femra.

Foto 6: Numri i kuadrit realizues ne te gjitha TV




Në analizën e strukturës së të punësuarve në TV industrinë, ka edhe një kategori metodologjik – „kuadër tjetër“ (mbajtës/e i/e higjienës, shofer/e, sekretar/eshë etj), në të cilën gjithashtu ka zvogëlim të numrit të përgjithshëm të të punësuarve, njëkohësisht përfaqësimi i meshkujve është zvogëluar për 26, që është pothuajse për tri herë më shumë sesa zvogëlimi i numrit të femrave (dhjetë). Me këtë, është rritur dallimi në prezencën e gjinive në këtë kategori në favor të femrave, përkatësisht nëse në vitin 2016 ka pasur dy femra më shumë, në vitin 2017 ka pasur 19.

Foto 7: Kuadrot e tjera ne te gjitha TV



## Struktura gjinore e të punësuarve në televizionet nacionale


Foto 8: TV nacionale




Duke pasur parasysh se analiza e përfaqësimit të çështjeve gjinore edhe e paraqitjes edhe e përfaqësimit është realizuar në ekzemplar nga stacionet televizive nacionale, është e udhës që të shihet edhe si është struktura gjinore e të punësuarve në këtë segment të shërbimeve mediatike audiovizuale.

Nëse shikohen të dhënat për ndryshimet te drejtuesit/et, në vitin 2017 ka dy drejtues më pak sesa në vitin 2016, e numri i femrave mbetet i njëjti, përkatësisht joekzistues (Fotografia 8). Te drejtuesit/et ka zhvendosje të sigurt me të cilat numri i redaktueseve është zvogëluar për tre, ndërsa e redaktuesve për një (Fotografia 8).

Foto 9: Numri i gazetarëve(eve) ne TV nacionale



Megjithëse numri i gazetarëve/eve është zvogëluar për gjashtë (Fotografia 9), numri i femrave është rritur për një, ndërsa numri i meshkujve është zvogëluar për shtatë. Edhe në nivel të televizioneve nacionale kuadri i gazetarëve është kryesisht kuadër i femrave, me atë që ndryshimet e numrit të të gazetarëve/eve të punësuar ka çuar në dallim ende më të madh në favor të gazetareve të cilat në vitin 2017 janë për 81 më shumë.



Në kundërshtim me rritjen e të punësuarve në marketingun në nivel të industrisë televizive në tërësi, te televizionet nationale ka zvogëlim të vogël, përkatësisht në vitin 2017 ka një bur më pak dhe një femër më pak sesa në vitin 2016 (Fotografia 10).

Nga viti 2016 deri në vitin 2017 kuadri teknik në televizionet nationale është zvogëluar për katër – ndryshim i cili ka ndodhur te meshkujt, ndërsa numri i femrave është i pandryshuar - tre (Fotografia 11). Kjo kategori e të punësuarve mbetet kryesisht kategori meshkujsh – ndërmjet inxhinierëve/eve dhe teknikëve/eve ka 80 meshkuj më shumë sesa femra.


Te kuadri i realizuesve dominimi i meshkujve në vitin 2017 është bërë më i shprehur sesa më parë. Gjegjësisht, kjo është kategoria e vetme e të punësuarve te televizionet nationale e cila tregon rritje në numrin e përgjithshëm ku ka 16 persona plus (Fotografia 11), por rritja nuk është e barabartë nëse shikohet në aspektin gjinor. Janë punësuar 19 meshkuj, por ka tre femra më pak.



Foto 11: TV nacioanle


Numri i kuadrit teknik

Numri i kuadrit realizues



Kategoria „kuadër tjetër“ te Televizionet nacionale tregon 11 persona më pak në vitin 2017. Edhe këtu zvogëlimi nuk është i barabartë por është rezultat i asaj që janë punësuar 2 femra, ndërsa numri i meshkujve është zvogëluar për 13, kështu që femrat tani janë përsëri me numër më të madh se meshkujt (Fotografia 12).

Foto 12: Numri i kuadrit tjetër te TV nacionale



## Konkluzion

Siç mund të shihet, edhe në televizionet nacionale edhe në industrinë televizive në përgjithësi, politikat redaktuese planifikohen në mjedise ku dominojnë meshkuj (pronarë, drejtorë, redaktorë), ndërsa realizohen nga kategori e të punësuarve në të cilën dominojnë femrat (gazetaret), në bashkëpunim me kuadër teknik dhe realizuesish – ku përsëri dominojnë meshkuj.

Që të lëvizin më përpara situatat tanimë të krijuara në aspekt të gjinive në ekranin, nevojitet që edhe pas ekranit të ndryshohet vetëdija dhe mënyra e të kuptuarit te mediat për rëndësinë e

përfshirjes më të madhe të femrave në të gjitha nivelet në industrinë audiovizuale sepse në këtë mënyrë shoqëria është e privuar nga mundësia për t'i parë rezultatet nga kreativiteti i gjysmës së popullatës.

## Në ekranin

Siç është përmendur më lart, lajmet dhe reklamat ishin lëndë e analizave vjetore për trajtimin e çështjeve gjinore dhe mënyrës së paraqitjes dhe përfaqësimit të femrave dhe meshkujve në një periudhë kohore gjashtëvjeçare (2012-2017). Këto analiza, të përpunuar për ose nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, dhanë indikatorë për trendët në aspekt edhe të përpunimit të çështjeve gjinore, edhe në aspekt të (pa) vetëdijes për validitetin dhe nevojën që gjinia të shfrytëzohet si aspekt relevant gjatë përpunimit gjithëpërfshirës dhe analitik të temave aktuale dhe kronike të cilat janë të rëndësishme për jetën e qytetarëve/eve në shtetin, dhe për përsëritjen ose shkaktimin e stereotipave gjinore dhe për pranimin ose refuzimin e objektivizmit ose seksualizmit në paraqitjen. Prandaj, ishte koha që të hulumtohet një segment i ri i programit.

Emisionet e mëngjesit/drekës, janë programe përmes të cilave mediat e fillojnë më shpesh paraqitjen e tyre ditore gazetareske para publikut. Përveç kësaj, ato janë edhe emisione që kanë publik potencialisht të ndryshëm: nga fëmijët (në moshë parashkollore, filloristë dhe të shkollës së mesme), përmes të rinjve, njerëzit në moshë të pjekur, e deri te pensionistët - të gjithë ato, nëse e kalojnë mëngjesin në shtëpi, mund të shikojnë ndonjë prej këtyre emisioneve. Prandaj, si ekzemplar për këtë analizë të shtatë të trajtimit të çështjeve gjinore dhe mënyrës së paraqitjes dhe përfaqësimit të femrave dhe meshkujve në programet e televizioneve terestriale nacionale i zgjedhëm emisionet e televizioneve nacionale që fillojnë gjatë mëngjesit.

Përsëri lëndë e analizës ishin televizionet që arrijnë shikueshmëri më të madhe me ç'rast mund të pritet edhe ndikim më i madh, përkatësisht shtatë serviset programore televizive që transmetohen përmes multipleksit terestrial nga të cilat dy janë të Servisit radiodifuziv publik: MRT1 dhe MRT2 – Programi në gjuhën

shqipe, ndërsa pesë janë privat: TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel dhe TV Telma. Nga programi që e kanë emituar në maj 2018, u zgjodh ekzemplar nga pesë emisione të mëngjesit/drekës të paraqitur në ditët e punës në datat vijuese: 28 maj (e hënë), 22 maj (e martë), 16 maj (e mërkurë), 10 maj (e enjte) dhe 4 maj (e premte). Me atë u formua ekzemplari nga gjithsej 35 emisione – me kohëzgjatje të ndryshme dhe strukturë të ndryshme.

Analiza e emisioneve mëngjesore në fakt ishte me dy shtresa. Së pari u bë një këqyrje në përmbajtjen e përgjithshme të emituar dhe ajo u kategorizua sipas karakteristikave të saj komunikuese siç janë funksionin që e përmbush ose publiku për të cilin është dedikuar (fëmijë ose të moshuar). Kjo tregon se disa prej televizioneve i kanë koncipuar emisionet e tyre mëngjesore duke e pasur parasysh diversitetin e publikut potencial, përkatësisht në të kanë përfshirë përmbajtje edhe për fëmijë edhe për të moshuar, që janë sipas funksionit edhe zbavitës edhe informativë edhe edukativë<sup>8</sup>. Për shembull, „Maqedonia në mëngjes“ në RTM1 është emision mëngjesor tipik informativ-zbavitës në të cilin diçka mbi gjysma e përmbajtjeve janë me funksion informativ, afro një e treta janë zbavitëse, ndërsa pjesa tjetër është edukative. E ngjashme është struktura e „Ditë e re“ në TV Alsat M, ku ka më shumë elemente informative e më pak elemente arsimore. Zbavitëse-informative është edhe "Mëngjesi në Telma" (Utrinska në Telma), në të cilin segmentet me funksion informativ përbëjnë diçka nën një të tretën, zbavitëse janë afro një e treta, ndërsa edukative janë të pranishme me 3%. Në mesin e atyre informative-zbavitëse numërohen edhe „E dua Maqedoninë“ në TV Sitel ku funksioni informativ dominon, informatat zbavitëse paraqesin diçka më pak se një të tretën, ndërsa ato edukative përbëjnë 12%. Programi në gjuhën shqipe në RTM2 në „Zgjohu me ne“, ka vendosur t'i bëjë thirrje publikut i ndryshëm sipas moshës, por duke i prezantuar para së gjithash zbavitje (diçka më

---

<sup>8</sup> Detaje për temat për të cilat është raportuar edhe për mënyrën e përpunimit të tyre gazetaresk, si dhe për përfaqësimin e secilit funksion të gazetarisë/medias në emisionet e analizuara ka në raportet e veçanta që vijojnë pas kësaj hyrjeje.

shumë se 82%). “Alfaskop” në TV Alfa është koncentruar në funksionin informative (më shumë se 90%), në të cilin element kryesor është kontakti dhe diskutimi me shikuesit, ndërsa pjesa tjetër janë segmente zbavitëse. Edhe “Tungjatjeta Maqedoni (Zdravo Makedonijo)” në TV Kanal 5 është pothuajse emision informativ (vetëm 3%). Ky emision, në pjesën më të madhe, është përkushtuar në transmetimin e qëndrimit të qytetarëve qoftë përmes kontaktit telefonik me shikuesit qoftë përmes anketave gazetareske. Programet në TV Alfa, TV Kanal 5 dhe TV Sitel janë dizenuar për popullatën e rritur, përkatësisht në emisionet e analizuar nuk ka përmbajtje për fëmijë.

Në nivelin e ardhshëm analitik, përkatësisht gjatë analizës në aspekt të prezencës dhe trajtimit të gjinisë, janë analizuar vetëm ato përmbajtje që janë prodhim gazetaresk konkret të krijuar/dedikuar për atë emision. Kjo do të thotë nëse në kuadër të emisionit janë transmetuar lajmet – ato nuk janë analizuar kronikë për kronikë, por konstatohet niveli i pjesëmarrjes në përmbajtjen e plotë të emisionit mëngjesor sepse kësaj here, njoftimi në lajmet nuk është lëndë e analizës. Gjithashtu, edhe filmat e animuar dhe dokumentarë, emisionet për gatim dhe përmbajtjet e ngjashme nuk janë analizuar në aspekt të figurave/temave në to, sepse ato janë prodhuar nga ekipe tjera dhe për nevoja tjera, ndërsa vendin e vet në emisionet e mëngjesit/drejtës e sigurojnë për shkak të qëllimit konceptuar të medias që të sigurojë kolazh pikërisht për shkak të nevojave të ndryshme të publikut të ndryshëm.

Do të thotë, në fokus ishin segmente/kronikat e emituar drejtpërdrejt ose të përgatitura paraprakisht nga ekipi i cili zakonisht i planifikon dhe i realizon këto emisione. Njëkohësisht u tregua prezencë e ndryshme e temave gjinore dhe qasjes së ndryshme. Te TV Alfa dhe TV Kanal 5, gjinia është pothuajse temë joekzistuese, e cila, në raste të rralla kur do të paraqitet, përgjithësisht trajtohet tradicionalisht, në mënyrë konservative dhe patriarkale. Te TV sitel ka vetëdije më të madhe për rëndësinë e temave, me ç’rast mund të vërehet dualitet i caktuar në qasjen gazetareske - nga njëra anë në disa segmente hapen çështje që janë të rëndësishme për barazinë e

femrave dhe meshkujve, e te të tjerë ekziston qasje tradicionale, konservative në rolet gjinore. Te RTM1 dhe RTM2 çështjet gjinore nuk janë shumë shpesh të pranishme, por qasja tregon vetëdije të caktuar gjinore te redaksia dhe gazetarët/et në programin mëngjesor. Në TV Telma temat gjinore dhe aspektet janë më të përfaqësuar me ç'rast qëndrimet e ndryshme dhe shkallët e vetëdijes në aspekt të tematikës gjinore varen nga karakteri i temës e cila përpunohet në secilën prej tërësive tematike.

Për shumicën e emisioneve të analizuara mund të konstatohet se gjatë fjalimit përdoret gjuhë e verbër gjinore, përkatësisht gjini gramatikore mashkullore edhe atje ku është e drejtë të përdoret gjinia femërore - kjo është më e dukshme te profesionet dhe funksionet e femrave, ndërsa ndonjëherë shpie edhe në situata qesharake - siç do të shihet nga disa shembuj në analizat e veçanta. Përjashtim janë RTM1 dhe RTM2 ku më shpesh përdoret gjinia e drejtë gramatikore.

Në përbërjen e ekipeve gazetareske më shpesh vërehet përfaqësimi i barabartë i gazetareve dhe gazetarëve me atë që te RTM1 ekziston prezencë shumë e madhe të femrave. Te ato televizione te të cilat është konstatuar qasje tradicionale dhe konservatore në çështjet gjinore (TV Alfa, TV Kanal5) vërehet se për temat nga sfera e politikës më shpesh janë të angazhuar gazetarët, ndërsa gazetaret janë të angazhuar për përmbajtje zbatimëse-informative, shëndetësi, tema nga jeta e përditshme etj.

Sa i përket përfshirjes së qëndrimeve dhe profesionalizmit, përvojës dhe mendimeve të femrave dhe meshkujve, mund të vërehet se në lidhje me bashkëbisedueset dhe bashkëbiseduesit me të cilat realizohen intervistat, te TV Telma, TV Kanal5, TV Alfa, TV Alsat M dhe RTM1 ekziston barazi e caktuar, e cila është më e vogël në TV Sitel dhe RTM2. Në aspekt të shikuesve/eve që paraqiten përmes telefonit për të marrë pjesë në forumin për debat që është siguruar në disa prej programeve karakteristike për pjesëmarrjen e tyre është se meshkujt më shpesh paraqiten për të diskutuar për politikë (ditore), ndërsa femrat për tema shëndetësore. Gjithsesi, televizionet nuk mund të ndikojnë mbi strukturën gjinore të këtij segmenti.

Gjatë prezantimit fizik në asnjë media nuk ka shembuj të seksualizmit ose objektivizmit, me një përjashtim që është futur nga tema e cila përpunohet - bukuria e femrës.



TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

**Ekzemplar për analizë:**

Emisioni mëngjesor  
"Maqedonia në mëngjes",  
edicione nga 4, 10, 16, 22, 28  
maj 2018.

**Zhanri:**


Informative-argëtuese  
(Fotografia 13).



**Temat:**

- Informacione;
- Kulturë dhe art (shfaqje, ekspozita, festivale, koncerte etj),
- Shëndet,
- Arsim,
- Të ushqyerit,
- Sport,
- Evenimente humanitare
- Kuriozitete etj.



Foto 13: Struktura emisionëve sipas funksionit të programeve (MRT1):



### Mënyra e përpunimit:

Raporte dhe intervista (të incizuara ose drejtpërdrejt), emisione dokumentare, info-servise.

### GJINIA NË “MAKEDONIJA NAUTRO (MAQEDONIA NË MËNGJES)”




Në mesin e bashkëbiseduesve/eve ka më shumë femra, përkatësisht numri i përgjithshëm i bashkëbiseduesve është 34, ndërsa bashkëbiseduesit 26 (Fotografia 16). Bashkëbisedueset më shpesh janë në moshë mbi 46 vjet, ndërsa bashkëbiseduesit vlerësohet se më shpesh janë nga 31 deri 45 vjet.

Bashkëbisedueset janë në funksione të larta: drejtoreshat, zëdhënëset, profesoret e fakultetit, kryetarët e shoqatave, përfaqësueset nga ndërmarrjet publike etj, e flasin në tema nga sfera kulturës, artit, arsimit, shëndetit, organizatave joqeveritare dhe projekteve.

Bashkëbiseduesit janë përfaqësues të ndërmarrjeve publike, drejtorë, kryetarë komune, maratonë, ambasadorë etj. Flasin në tema si: shëndeti, sporti, kultura, mjedisi jetësor, organizatat joqeveritare dhe projektet.

Fotografia 16



### **Gjuhë:**

Në lidhje me gjuhën që e përdorin gazetarët/et, konstatohet se më shpesh përdoret gjuha afirmative ndaj barazisë gjinore (gjatë prezantimit gjuhësor të profesioneve të femrave përdoret gjinia gramatikore femërore, vetëm në një rast ka gjini mashkullore). Por, në prezantimin e funksionit të mysafirëve përdoret gjinia mashkullore.

### **Shembuj:**

Gjithsej janë analizuar 84 kronika, nga të cilat gjashtë janë në tema gjinore, përkatësisht kanë aspekt gjinor.

RTM1 mund të ndajë si shembull pozitiv për përfshirje të temave gjinore në programin. Një temë e tillë është përpunuar në shtojcë të emituar më 4 maj, që ka të bëjë me nënat e vetme. Më konkretisht, bëhet fjalë për projekt të organizuar nga ana e Organizatës së femrave nga Manastiri, të mbështetur nga asociacioni i qytetarëve Most përmes Bashkimit Evropian. Bashkëbisedueset flasin për realitetin e nënave të vetme, përmes shembujve e sqarojnë situatën e tyre dhe i paraqesin të dhënat nga anketa e realizuar në familjet ku ka prind të vetëm. Një prej bashkëbiseduesve është nëna e vetme dhe i përcjell problemet me të cilat ajo ballafaqohet. Në fund të kronikës gazetarja i cek edhe projektet tjera të Organizatës së femrave nga Manastiri siç janë: ndihma e të moshuarve në kushte shtëpiake dhe projekti më i ri me temë sensitiviteti gjinor në sportin te të rinjtë në Manastir.

Rubrika e rregullt “Femrat nëpër shekuj”, është kushtuar figurave femra që kanë lënë gjurmë në historinë botërore. Në rastin konkret (nga 28 maj) flitet për ish-gjymnasten rome Nadja Elena Komaneçi – gjymnastja e parë të cilës arbitri i lojërave olimpike i ka dhënë notë 10. Gazetarja nga studioja, duke njoftuar për kronikën tha se “shumë femra me veprat e tyre e kanë bërë botën vend më të bukur për të jetuar”. Autorja e kronikës, e përshkruan hollësisht gjithë jetën e gjymnastes, nga fillesat e saj në gjymnastikë përmes sukseseve të saj të mëdha deri në pensionimin e saj. Në kronikën përdoret gjuha afirmative për barazi gjinore.

Për shembull në të cilën ekziston barazi gjinore në prezantimin e roleve, është kronika që ka të bëjë me zhvillimin historik të biçikletës dhe rëndësinë e saj, në të cilën gazetarja e përmend konstruktimin edhe të biçikletës për femra, që ka mundësuar ta ngasë atë edhe me fund të gjatë. Gjithë kronika është shoqëruar me inserte nga fillesat e përdorimit të biçikletës nëpër botë e gjer më sot, e në të cilat meshkujt dhe femrat janë të përfshirë në mënyrë të barabartë (28 maj).

Në kronikën kushtuar ekspozitës së vizatimeve të Artistes maqedonase Gordana Vinçiq (22 maj), i jepet rëndësi të madhe fuqisë së femrës, si figurë e forte dhe dominuese. Gjatë bisedës, gazetarja komenton se shpesh femra është lëndë e frymëzimit të artistes dhe se në veprat e saj mashkulli paraqitet shumë pak. Këtu artistja shton se është e magjepsur nga energjia e femrës e cila në natyrën e nxit mashkullin ta mbështesë në jetën e saj.

Shembull tjetër i cili mund të veçohet si më i rëndësishëm është kronika nga rubrika "Moda" (nga 4 maj) në të cilën, në vend që të flitet për këshilla dhe udhëzime për trendët e modës të dedikuara për femrat, siç është rasti shpesh me kronika të tilla, aty flitet për modën e mashkullit, përkatësisht janë prezantuar trendët pranverore të mashkullit që do ta shënojnë sezonin pranverë/verë 2018. Me prezantimin e roleve ku trendët e modës janë dedikuar më shpesh për femrat, që e potencon edhe gazetarja duke thënë: “siç janë prezantuar trendët femërore pranverore, ashtu janë pritur edhe trendët e mashkullit”.

Në intervistën me maratonën më të mirë maqedonas Aleksandar Kiraxhiev, që flet për maratonën e Shkupit dhe për sfidat e tij, gazetarja e përmend motrën dhe bashkëshorten e tij si

pjesëmarrës në maratonën e Shkupit me të cilat bashkëbiseduesi është përgatitur gjatë gjithë vitit (4 maj).

**Paraqitja dhe prezantimi:**

Në emisionet e analizuara mëngjesore nuk i jepet rëndësi pamjes fizike të udhëheqësve/eve dhe mysafirëve, as në përmbajtjet e kronikave nuk ekziston mënyrë e objektivizuar e prezantimit të femrave dhe meshkujve.

**Konkluzion:**

Nga analiza e kryer gjinore e ekzemplarit nga pesë edicione “Maqedonia në mëngjes” të emituar në RTM1 në maj 2018, mund të konkludohet se ekziston vetëdije për çështjen gjinore te redaksia dhe gazetarët/et në programin mëngjesor. Kjo pasqyrohet si përmes përfshirjes së aspektit gjinor në trajtimin e çështjeve gjinore në kronikat, ashtu edhe në përdorimin më të shpeshtë të gjuhës afirmative gjinore, dhe në mbajtjen e llogarisë që të përfshihen qëndrimet dhe perspektivat e femrave, që shihet përmes faktit që në emisionet janë përfshirë më shumë bashkëbisedues. Në realizimin e emisionit marrin pjesë edhe shumë gazetarë sesa gazetarë.

### Të dhënat e përgjithshme

#### **Ekzemplar për analizë:**

Emissioni mëngjesor “Zgjuhu me ne”, edicione nga 4, 10, 16, 22, 28 maj 2018

#### **Zhanri:**

Programi zbavitës (Fotografia 17).



#### **Temat:**

- Përmbajtje për fëmijë,
- Sport,
- Horoskop,
- Kuriozitete
- Reportazhe,
- Kultura dhe arti (literature, muzika, festivale etj),
- Arsim,
- Të ushqyerit,
- Aksione humanitare etj.



Foto 17: Struktura emisionëve sipas funksionit të programeve (MRT2):



### Mënyra e përpunimit:

Intervista (drejtpërdrejt ose të incizuara), filma të animuara dhe tregime për fëmijë (“Këndi për fëmijë”), reportazhe, kronika me përmbajtje zbavitëse.

### Gjinia në “Razbudi se so nas (Zgjoju me ne)”




Në mesin e bashkëbiseduesve/eve ka më shumë femra, përkatësisht numri i përgjithshëm i bashkëbiseduesve është 34, ndërsa bashkëbiseduesit 26 (Fotografia 20). Bashkëbisedueset më shpesh janë në moshë mbi 46 vjet, ndërsa bashkëbiseduesit vlerësohet se më shpesh janë nga 31 deri 45 vjet, dhe ka pesë djem.

Pesë bashkëbisedues paraqiten në role të studenteve, këngëtareve, sportistëve etj, që flasin për sportin, muzikën, kremtimet e maturës, arsimit...

Bashkëbiseduesit janë në role të klarinetistit, botuesve, trajnuesve, sportistëve, anëtarëve të shoqatave, profesorëve, fotoreporterëve etj, ndërsa flasin në tema si: sporti, muzika, panairi i librave, dhurimi i gjakut etj.

Fotografia 20



#### Gjuhë:

Në gjuhën që përdoret në emisionin ekziston gjini e drejtë gramatikore gjatë prezantimit të bashkëbisedueseve - si për shembull sportiste, futbolliste, maturante.

#### Shembuj:

Në emisionet e analizuara ka gjithsej 47 segmente nga të cilat 29 kronika u analizuan nga aspekti gjinor, e në pesë prej tyre përpunohen tema gjinore ose ka aspekt gjinor.

Shembull pozitiv, në të cilin ekziston qëndrim kritik ndaj prezantimit tradicional të femrave, është shtojca me titull "Si t'i definojmë femrat" (22 maj), në të cilin flet për atë se si femrat shihen nga ana e meshkujve, por edhe nga shoqëria në tërësi. Gazetarja e prezanton rolin tradicional të femrës nëpër gjithë jetën e saj. Ajo thotë se tradicionalisht, me lindjen e vajzës gëzimi të afërmit nuk është e aq i madh siç është gjatë lindjes së fëmijës mashkull, e pastaj vazhdon në fëmijërinë dhe vitet e tinxherëve të femrës, nga e cila, në këtë periudhë nga jeta e saj pritet të jetë shembullore, të sillët mire sepse nuk është mashkull, të mësojë dhe të mos ketë të dashur.

Në lidhje me karrierën e femrës, në sytë e meshkujve, ajo shihet si objekt seksual, përkatësisht i jepet rëndësi pamjes fizike, e jo inteligjencës së saj. Konsiderohet se femra nuk mund të jetë karrieriste nëse nuk është e veshur me fund të shkurtër dhe nëse nuk është me bel të hollë. Këtu, theksohet stereotipi që paraqitet kur



bëhet fjalë për karrierën, e sipas të cilit femra nuk mund të ketë familje dhe të kujdeset për shtëpinë dhe familjen nëse dëshiron të ndërtojë karrierë. Në fund të kronikës, konkludohet se viktimizimi i femrave në përpjekjet për t'u flakur kuptimi tradicional është i madh, por megjithatë kjo botë nuk do të ishte vend i mirë për të jetuar pa femrat.

Shembulli i dytë pozitiv është nga dita e njëjtë, ndërsa bëhet fjalë për bisedë me vajzë e cila është futbolliste profesioniste me përvojë të madhe dhe njohuri të madhe të lojës së futbollit. Mysafirja flet për fillimet e saj në botën e futbollit dhe për sukseset e saj. Në pyetjen: „Sa janë përfshirë vajzat në këtë sport dhe sa mbështetet futboli i femrave te ne?“, ajo përgjigjet se vajzat me të madhe përfshihen në sport dhe se më herët ka qenë absurde që vajza të merret me futboll, por tani kuptimet janë më të ndryshme. Në këtë mënyrë bashkëbiseduesja e hedh poshtë kuptimin se futboli është sport meshkujsh, dhe se përfshirja e femrave sjell ndryshime pozitive.

Në kronikën e tretë (28 maj) bëhet fjalë për prezantimin e shqiptarëve/eve më të suksesshëm në botë në të cilën, përveç meshkujve, një numër i madh paraqiten edhe femra që, siç thotë gazetarja, janë dalluar në fusha e tyre të punës, kanë kaluar përmes shumë peripecive dhe sfidave gjatë karrierës, por falë këmbënguljes së tyre i kanë realizuar ëndrrat e tyre.

Gjithashtu, si shembull pozitiv mund të veçohet kronika në të cilat bashkëbisedueset janë dy maturante që flasin në temë mbrëmja e maturës dhe që mendojnë se nuk duhet t'i jepet rëndësi të madhe dukjes fizike dhe të harxhohet një shumë e majme e parave për makijazh dhe fustane të shtrenjta (10 maj). Ato rëndësi të madhe i japin arsimit dhe sjelljes shembullore që duhet ta ketë një maturant.

Si shembull negativ paraqitet kronika ku flitet për ngrënien vonë dhe janë dhënë të dhëna nga ana e shkencëtarëve për pasojat negative (22 maj). Kjo kronikë është përpunuar në mënyrë informative dhe është dedikuar për të gjithë shikuesit, por në fotografitë që janë përdorur për ilustrime shihen femra me çka jepet pasqyrë se kjo kronikë është e dedikuar vetëm për femra, përkatësisht përcillet stereotipi se femrat duhet të jenë të holla dhe të dobëta, me ç'rast për to problem është të hanë shpejt.

**Paraqitje dhe prezantim:**

Në emisionin mëngjesor, as udhëheqëset as mysafirët nuk janë prezantuar në mënyra që do të kishin tërhequr vëmendje ndaj dukjes së tyre fizike.

**Konkluzion:**

Në pesë emisionet e analizuara të programit mëngjesor “Zgjohu me ne” në RTM2 në gjuhën shqipe ka disa shembuj pozitivë për tema të trajtuara në mënyrë që tregojnë angazhim për barazi gjinore që bashkë me përdorimin e gjinisë së drejtë gramatikore tregojnë atë se te redaksia dhe ekipi i emisionit ekziston vetëdije për rëndësinë e kësaj çështjeje. Megjithatë, bashkëbiseduesit janë më shpesh meshkuj.

### Të dhënat e përgjithshme

**Ekzemplar për analizë:**

Emisioni mëngjesor „Ditë e re“, edicionet nga 4, 10, 16, 22, 28 maj 2018.

**Zhanri:**

Programi informativ-argëtues (Fotografia 21).



**Tema:**

- Informacione,
- Kultura dhe arti (ekspozita, literatura, arti, shfaqja teatrale, muzika etj),
- Shëndeti,
- Sporti,
- Evenimentet humanitare,
- Kuriozitete etj.

Foto 21: Struktura emisionëve sipas funksionit të programeve (Alsat M):




### Mënyra e përpunimit:

Raporte, intervista (drejtpërdrejt ose të incizuara), paraqitje të drejtpërdrejta nga korrespondentët ose TV stacionet tjera, reportazhi, info-servis.

### Gjinia në „Dita e re“




Në aspekt të stafit redaktues – pjesën e fundit paraqitet vetëm emri i kryeredaktorit dhe redaktorit përgjegjës i servilit i cili është mashkull (Fotografia 23).



Bashkëbiseduesit dhe bashkëbisedueset, që janë gjithsej 23 – nëntë femra dhe 14 meshkuj (Fotografia 24), më shpesh janë në moshë prej 31 deri në 45 vjet, me atë që katër janë nën 18 vjet: dy djem dhe dy vajza.

Femrat që paraqiten si bashkëbiseduese janë në funksion të doktorëve, aktoreve, alpinistëve etj, që flasin për sportin, shëndetin, aktrimin, artin. Bashkëbisedueset paraqiten në funksion të alpinistëve, doktoreshave, mjeshtërit të picave, aktorëve, profesorëve, drejtorëve etj, ndërsa flasin për: shëndet, sport, kulturë, gatim, aktrim etj.



### Gjuha:

Nuk ka senzitivitet gjinor për përdorimin e gjinisë së drejtë gramatikore, përkatësisht shpesh gjinia gramatikore mashkullore përdoret si gjini asnjëherë edhe gjatë prezantimit të profesioneve femërore (doktor në vend të daktoreshë etj).

### Shembuj:

Nga analiza e 40 kronikave, vetëm në dy prej tyre ka aspekt gjinor.

E para ka të bëjë me aksionin humanitar edukativ të alpinistëve, për të cilin informohet përmes bisedës me dy mysafirë në studio – një mashkull dhe një femër. Gjatë emisionit (4 maj), një prej gazetareve e pyet alpinisten për atë se sa janë të interesuar qytetarët që të jenë anëtarë në këto shoqata, ndërsa përgjigja e alpinistëve është se numri i femrave kohët e fundit rritet për dallim nga më parë kur ka qenë shumë më i vogël. Ajo thotë se asnjëherë nuk do të tërhiqet nga alpinizmi dhe se ka arritur të përfshijë edhe dy femra tjera në këtë sport. Me prezencën si mysafire e alpinistes dhe përgjigjet e saj thyhet stereotipi për alpinizmin si sport kryesisht për meshkuj në të kaluarën dhe e dëshmon aftësinë e femrës dhe është frymëzim për të gjitha femrat që synojnë ta arrijnë atë që u duket e paarritshme.

Shembulli i dytë pozitiv (22 maj) është intervista me gjinekologun ku temë e bisedimit është infertiliteti te meshkujt dhe

femrat, faktorët që e shkaktojnë, mënyra e trajtimit etj. Gjatë bisedimit, gazetarja e pyet doktorin çfarë kontrole bëhen kur konstatohet infertiliteti, ku doktori përgjigjet se për dallim nga më herët kur vetëm femra është kontrolluar dhe është konsideruar se ajo është fajtorja për infertilitetin, sot kuptimet kanë ndryshuar, përkatësisht edhe meshkujt vijnë për t'u kontrolluar. Në këtë mënyrë jepet informatë e rëndësishme, gjnare, e ndarë, e cila tregon se një problem shëndetësor, i cili tradicionalisht është konsideruar se është problem për/te femrat, paraqitet në realitetin e tij - si problem për të dyja gjinitë.

#### **Paraqitja dhe prezantimi:**

Prezantimi i bashkëbiseduesve, bashkëbisedueseve dhe gazetarëve/eve është neutral, përkatësisht nuk haset as objektivizmi as seksualizmi.

#### **Konkluzioni:**

Ajo që mund të vërehet nga analiza e çështjeve gjnare në "Ditë e re" është prezenca minimale e temave që mund të trajtohen në aspektin gjnor, shfrytëzimi i gjnisë gramatikore mashkullore, gjatë prezantimit të profesioneve të femrave; numër më i vogël i bashkëbisedueseve për dallim nga bashkëbiseduesit që janë më shumë. Kjo tregon se nuk ekziston vetëdije për nevojën për trajtim të temave relevante për barazi të gjnive ose për gjninë si pozitive legjitime në informimin dhe analizën gazetareske.

## Të dhënat e përgjithshme

### Ekzemplar për analizë:

Emisioni i  
mesditës „Alfaskop“,  
edicioni 4, 10, 16, 22,  
28 maj 2018.

### Zhanri:

Programi informativ  
(Fotografia 25).



### Tema:

- Tema aktuale shoqërore-politike dhe ekonomike,
- Shëndeti,
- Kultura/arti,
- Arsimi,
- Siguria në komunikacionin,
- Gastronomia,
- Siguria e fëmijëve në internet,
- Sukseset e të rinjve,
- Muzika,
- Kuriozitete etj.

Foto 25: Struktura emisionëve sipas funksionit të pro


Informative  
92%



### Mënyra e përpunimit:

Raporte, intervista (drejtpërdrejt ose të incizuara), kontakt i drejtpërdrejtë telefonik me shikues, lojëra, reportazh.

### Gjinia në „Alfaskop“




Në pjesën e fundit të emisionit nuk identifikohen redaktorët/et (Fotografia 27).

Si bashkëbisedues në studio janë të pranishëm si mysafirë 16 meshkuj dhe 10 femra, ndërsa në pjesën kontaktues, në pesë edicionet e analizuara paraqiten 48 meshkuj dhe 38 femra, përkatësisht në emision ka gjithsej 64 meshkuj dhe 48 femra (Fotografia 28).

Në lidhje me moshën, në studion janë të pranishëm 4 vajza nën 18 vjet, 5 femra dhe 8 meshkuj në moshë nga 31-45 vjet dhe 5 meshkuj dhe një femër në moshë mbi 46 vjet.

Femrat që paraqiten si bashkëbiseduese janë në funksion të dokoreshave, pjesëmarrësve, këngëtareve, profesorehave, valltareve etj, që flasin për shëndetin, arsimin, muzikën, gatimin etj. Bashkëbiseduesit janë doktorë, analistë, ekspertë, drejtorë, politikanë, stërvitës fitnesi etj, ndërsa flasin për: politikë, shëndet, sport, sigurim, komunikacion etj.





### Gjuha:

Udhëheqësit dhe udhëheqëset në „Alfaskop“ shpesh kanë kujdes të përdorin fjalim sensitiv gjinor.

### Shembuj:

Gjithsej janë analizuar 34 kronika, ndërsa tema lidhur me gjinitë paraqitet tri herë.

Më 22 maj, temë në pjesën në të cilën ndahet libri janë fejesat me ç’rast ka qasje tradicionale. Kronika fillon me shqyrtimin e fejesës si akt solemn, por në vazhdimësi i kushtohet shumë vëmendje dukjes së nuses sesa dhëndrit. Flitet për fustanin të cilin mund da zgjedhë, për kundrat etj, përkatësisht theksi vihet në aspektet fizike dhe mënyrat në të cilat nusja mund të paraqitet në edicionin e saj më të bukur, gjë që hyn në narrativin tradicional - për princeshën dhe princin në kalë të bardhë.

Ditën e njëjtë ka bisedë në studio me këngëtaren Natasha Mijatoviq - Mija përmes së cilës promovohet spoti i saj dhe kënga e re. Komponenti gjinore është e lidhur për spotin në të cilin janë paraqitur me dukje tradicionale dhe tekst jotradicional. Gjegjësisht, femrat janë veshur si amvise tipike me përparëse, e në tekstin flitet për amviset moderne, të cilat nuk i kryejnë rolet stereotipa të amvisave, të lajnë, të kollarisin, të hekurosin çdo ditë dhe të përgatisin ushqime tradicionale.

Në edicionin nga 28 maj në „Fjalë për fjale“ – segmenti i rregullt për kontakt me shikues drejtpërdrejt, shikuesit që paraqiten në

telefon diskutojnë në temë: „A prishet familja tradicionale?” Tema është e rëndësishme në aspektin gjinor, sepse i shqyrton edhe meshkujt edhe femrat në rolet e tyre gjinore, në një shoqëri tradicionale. Udhëheqësja disa herë përsërit se familja është qeliza më e rëndësishme në një shoqëri dhe i nxjerr të dhënat që flasin se në shtet nataliteti është në rënie të vazhdueshme dhe lidhen më pak martesat. Ajo citon hulumtim nga doc. dr. Makedonka Radulloviq nga Studimet familjare, për atë se materializmi dhe vitet e kaluara në arritjen e arsimit janë shkaqet e mundshme për formimin e vonshëm të familjes. Shikuesit konsiderojnë se këto ndryshme janë rezultat i ndjekjes së trendëve perëndimore dhe se na çojnë, siç thonë, në humbje, në humnerë (një shikuese bën thirrje të mos shkojmë drejt "asaj shoqëria të hapur"). Një nënë flet për birin e saj i cili është i siguar financiarisht, ka mbi 30 vjet, e siç thotë, nuk i shkon ndër mend të martohet dhe të formojë familje. Kuptimin e jetës dhe i krijimit të familjes, ndërtimit të shtëpisë etj, e sheh në atë që të ketë sa më shumë anëtar në tryezë. Vetëm njëra prej shikuesve në emisionin konsideron se mënyra moderne e jetës u jep të drejta më të mëdha femrave, duke thënë se ato tani trajtohen si njerëz, e jo si kafshë. Të gjithë të tjerët janë të mendimit se aspekti tradicional (shekullor, siç thuhet) duhet të ruhet. Shumica e shikuesve që paraqiten janë persona më të moshuar, me atë që kjo është tema e vetme ku ka më shumë femra ndërmjet shikuesve që paraqiten në telefon. Karakteristike është ajo që për çështje politike më shpesh paraqiten në telefon meshkuj. Shumica e shikuesve që paraqiten në telefon në emisionin kanë mendime konservative dhe tradicionale për temën, siç është edhe pozita e udhëheqëses.

Është karakteristike në Alfaskop ajo që rolet e udhëheqësve/eve janë ndarë në pajtim me kuptimet konservatore për rolet gjinore. Kështu, në edicionet e analizuara gazetarët e udhëheqin segmentin aktual-informativ, ku diskutohet për politikë dhe tema lidhur me ekonominë dhe drejtësinë, edhe në këtë pjesë mysafirë janë vetëm meshkuj. Vetëm në një edicion është ftuar Xhejllal Veliu nga E majta, por për fatkeqësisht ajo e ka refuzuar ftesën. Gazetarët janë të ngarkuar me detyrë për pjesën zbavitëse-informative, pjesën e shëndetësisë, për përgatitjen e reportazheve dhe kronikave të ndryshme nga jeta e përditshme.

**Paraqitja dhe prezantimi:**

Në edicionet e analizuara të emisionit të mesditës „Alfaskop“ nuk i jepet vëmendje të veçantë dukjes fizike të udhëheqësve dhe udhëheqëseve. Prezantimi i bashkëbiseduesve dhe bashkëbisedueseve në studion dhe në kronikat nuk është objektivizuese.

**Konkluzion:**

Temat gjinore ose aspekti gjinor i çështjeve shoqërore-aktuale pothuajse edhe të mos paraqitet në edicionet e analizuara të „Alfaskop“, e kur do të paraqiten qasja në to është tradicional, konservativ dhe patriarkal. Ka më shumë bashkëbisedues sesa bashkëbiseduese, e në mesin e shikuesve që paraqiten në programin – meshkujt më shumë diskutojnë në tema politike. Është pozitive ajo që më shpesh udhëheqësit dhe udhëheqëset kanë kujdes të përdorin gjuhë sensitive gjinore.



TV Kanal 5

### Të dhënat e përgjithshme

#### **Ekzemplar për analizë:**

Emisioni mëngjesor „Tungjatjeta Maqedoni“, edicionet nga 4, 10, 16, 22, 28 maj 2018.

#### **Zhanri:**


Programi informativ (Fotografia 29).



#### **Temat:**

- Temat aktuale shoqërore-politike,
- Shëndet,
- Të ushqyerit,
- Kuzhinieria,
- Kultura,
- Informata
- Kuriozitete etj.

Foto 29: Struktura emisionëve sipas funksionit të programeve (Kanal5):




### Mënyra e përpunimit:

Kontakti i drejtpërdrejtë telefonik me shikuesit, anketa me qytetarë, intervista, info-servis.

### Gjinia në „Zdravo Makedonijo (Tungjatjeta Maqedoni)“



Në pjesën e fundit të edicionit janë cekur emrat e drejtorit të Televizionit, tre redaktorëve dhe dy redaktoreve (Fotografia 31).



„Tungjatjeta


Maqedoni“, mbështetet në

aspektin konceptual në prezantimin e qëndrimeve të qytetarëve dhe ka numër të madh të bashkëbiseduesve që marrin pjesë përmes kontaktit telefonik ose në kronika me anketa gazetareske. Nga gjithsej 203 meshkuj, pesë janë bashkëbisedues (të intervistuar në studio ose paraqiten në kuadër të info servisit), 163 janë shikues që marrin pjesë në debat në temën e zgjedhur, ndërsa 35 prej qytetarëve të anketuar, ndërsa nga gjithsej 92 femra - 8 janë bashkëbiseduese (në studio ose paraqitje telefonike në info servis), 66 janë shikuese telefonuese dhe 18 të anketuar (Fotografia 32).

Mosha e bashkëbiseduesve nuk mund të caktohet te ato që paraqiten përmes telefonit, ndërsa në anketat: te meshkujt (35) - 29 janë të moshës mbi 46 vjet, tre janë nga 18 deri 30 vjet dhe tre janë nga 31 deri 45 vjet. Te femrat (18) – 16 janë mbi moshën 46 vjet, ndërsa dy nga 31 deri 45 vjet. Te të intervistuarit, një femër është në kategorinë e moshës së rritur nga 31 deri 45 vjet femra tjetër dhe dy meshkuj janë mbi 46 vjet.

## Gjuha:

Në TV Kanal 5, në tërësitë tematike dominon gjuha neutrale gjinore, përkatësisht përdorimi i gjinisë mashkullore të emrave dhe në rastet kur do të jetë në aspektin gramatikor e saktë të përdoret gjinia femërore. Neutralizimi i tillë më së shumti mund të vërehet në prezantimin e profesioneve të femrave, për shembull, në vend të meteorologe përdoret gjinia mashkullore – meteorolog. Në mënyrë të tillë, fshihet dukshmëria e femrave në sferën publike dhe në profesionet të cilat në aspektin stereotip llogariten për meshkuj, në vend të potencimit të tyre si shembuj pozitiv. Duke pasur parasysh atë se në pjesën më të madhe të programit dominojnë anketat dhe paraqitjet telefonike të shikuesve dhe qytetarëve, dominon edhe gjuha e verbër gjinore në të cilën nuk ka prezantim të roleve gjinore dhe profesioneve.



## **Shembuj:**

Në pesë emisionet janë analizuar gjithsej 65 segmente tematike nga të cilat me tema gjinore/aspekt gjinor – katër.

Më 16 maj, në fillim të emisionit, është emituar incizimi nga anketa me qytetarë në terren, me temë: "Shkupjanët ankohen se qyteti është i mbipopulluar dhe se njerëzit që vijnë nga qytetet tjera ua zënë vendet e tyre të punës – a kanë të drejtë ose jo?". Anketa është e përgatitur nga ana e gazetarit, i cili pyetjen kryesore e plotëson me deklaratën: "Vajzat tona thonë se nuk mund të martohem nga vajzat që vijnë dhe i marrin djemtë tanë, edhe kjo a është e vërtetë?...Nuk kanë mund të vijnë në radhë...Do të thonë: A, kjo ka ardhur këtu vetëm që të martohet". Në atë mënyrë, fjalimi dhe qëndrimi i gazetarit janë diskriminues, ku faji për mbipopullimin e kryeqytetit hidhet mbi femrat nga qytetet tjera. Femrat, përmes portretizimit të tillë janë prezantuar përmes kornizës tradicionale, si persona ambicia e së cilave është të bëhen bashkëshorte duke e parë martesën si mundësi për të jetuar në kryeqytet. Meshkujt, aspak nuk janë përmendur në kontekst të tillë diskriminues dhe tradicional. Gazetari duke tentuar të theksojë dukurinë shoqërore e cila e konsideron si negative, zgjedh që ta bëjë atë në kurriz të femrave nga qytetet tjera në vend.

Tërësi tjetër tematike me tematikë gjinore është emituar më 4 maj, me titull "Shkenca vërteton - me kë rri, bëhesh si ai". Në të, janë prezantuar rezultatet nga hulumtimi në të cilin thuhet se për trashësinë të meshkujt në vitet e dyzeta dhe pesëdhjeta të jetës, kontribuojnë miqtë e tyre "më të plotë". Gazetarja në prezantimin e rezultateve thotë se një pjesë e shkaqeve për të cilat meshkujt në fund të dekadës së katërtë dhe në fillim të dekadës së pestë të jetës „lëshojnë bark“ janë „jeta e rregulluar bashkëshortore, shujtat e rregullta, qëndrimi ulur gjatë kohë dhe mungesa e aktiviteteve" por edhe shoqërimi "me ortakë të trashë". Në këtë mënyrë, shkaqet për dukjen e meshkujve kërkohen fillimisht në shtëpi, gjë që është aspekt tradicional i meshkujve në kuadër të martesës dhe familjes, e më tutje edhe në ndikimin nga miqtë me peshë të caktuar trupore. Në fakt, përmes prezantimit të tillë, e duke pasur parasysh atë se një pjesë e madhe e përmbajtjeve në emisionin kanë të bëjnë me këshilla për dobësim, martesë portretizohet si e dëmshme për dukjen e meshkujve dhe peshën e tyre. Më tutje, përmes një analize më të

thellë, shkaqet gjenden edhe në rrethin e miqve, gjë që është përsëri prezantim tradicional, për shkak të mundësisë më të madhe për meshkujt për të lëvizur në rrethin e miqve, përkatësisht jashtë kornizave të shtëpisë, e cila konsiderohet se është më shumë sferë e femrave.

Më vonë ditën e njëjtë, është transmetuar tërësi tematike në të cilën shikuesit dhe shikueset janë inkuadruar drejtpërdrejt dhe bisedojnë në temën - "Ligji për gjuhët ende nuk është dërguar në "Gazetën zyrtare". A mund të ndodhë kjo pa nënshkrim të Presidentit Ivanov?". Gjatë tërësisë tematike, numri më i madh i shikuesve që janë inkuadruar në studio janë meshkuj, të cilët tregojnë interesim më të madhe për çështje politike. Në fund të tërësisë tematike, në emisionin inkuadrohet shikuese e cila e kritikon punën e medias, më saktësisht politikën redaktuese dhe qëndrimin e medias ndaj çështjeve politike. Gazetari, pas telefonatës së shikueses, ndjen nevojë për të dhënë sqarim dhe thotë: "Mua më vjen keq që ka zemërim te një pjesë e njerëzve në përgjithësi ndaj jetës, e të mos flas për partitë. Ja, ju jeni shembull personal, konkret për gjithë atë sepse parandjeva që kur e thatë atë "alo Robert, më dëgjo" kah do të shkojë biseda, por dëshiroja t'ju dëgjoj deri në fund. Dhe më vjen keq që është ashtu. E kuptoj te mashkulli të ketë zemërim, por te femra të ketë, kjo për mua është për t'u habitur, nuk e di. Dhe më vjen keq për këtë". Gazetari, i provokuar nga kritika e shikueses, i thotë pikëpamjet e tij personale për zemërimin te femrat, të cilin konsideron si të çuditshëm. Përsëri, portretizimi i tillë i femrave është tradicional, përmes të kuptuarit sipas të cilit femra duhet të jetë e matur dhe e qetë në qëndrimet dhe sjelljet e saj. Kuptimet e tilla bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me aftësitë te femrat për mendim kritik dhe të drejtën për ta artikuluar te publiku. Në këtë mënyrë, përforcohen fotografitë rigide për femrat dhe fisnikëria dhe dëgjimi i tyre i dëshiruar.

Tërësia e fundit tematike në të cilën vërehet tematika gjinore është transmetuar përsëri më 4 maj (e premte) kur emisioni përmban pjesë plotësuese për mysafirë në studion. Bëhet fjalë për intervistë me shkrimtaren dhe gazetaren Ana Jovkovska, në lidhje me promovimin e librit të saj të re "Jehona e lirisë". Kjo është tërësi tematike e udhëhequr nga ana e gazetares. Duke u përgjigjur në pyetje për atë se cili ka qenë frymëzimi për librin, Jovkovska, mes



tjerash, thotë se njerëzit e afërm kanë konsideruar se si "nënë e re (taze), me foshnjë" nuk do të mund ta bëjë atë, sepse për të krijuar duhet vetmi. Pastaj vazhdon:

Jovkovska: „*Reaksionet e para të njerëzve ishin se është thjesht çmenduri ideja ime se në këtë periudhë duhet t'i përkushtohem një gjëje të tillë. Por nuk di se kush ishte nxitja më e madhe, vallë dëshira për t'u dëshmuar të tjerëve, ose ndoshta edhe nevoja për t'i dëshmuar vetes se kur do të bëhesh nënë jeta vazhdon tutje, dhe se kjo nuk do të thotë izolim veçanërisht në shtëpi por se thjesht mund me organizim të mirë, me vetëdisiplinë e cila është shumë e rëndësishme...*“

Gazetarja: „*Nëna si nënë, gjithmonë di të organizohet*“.

Jovkovska: „*... Po, të organizohesh dhe ta bësh atë që do të të plotësojë. Sepse njëra të mbush me dashuri të jashtëzakonshme prindërore, ndërsa tjetra thjesht t'i mbush bateritë e kreativitetit të cilat gjithashtu janë të nevojshme që t'i të ndjesh se zhvillohesh. Unë, së paku, jam njeri që dëshiron të punojë vazhdimisht në zhvillimin personal dhe nuk i dua ato pozita të status kuosë, kur mbetesh gjatë në ndonjë pozitë, por dua të kem vazhdimisht sfida të reja dhe disi t'i tejkaloj edhe kufijtë e mi. Jo vetëm kufijtë shoqërore, por më shumë edhe ato personale*“.

Përmes përgjigjes së tillë, bashkëbiseduesja e hap çështjen e perceptimit të amësisë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet. Flet për kuptimet e mjedisit në lidhje me amësinë, që në esencë janë tradicionale, dhe për mënyrën e ballafaqimit me to, e në atë mënyrë edhe demaskimin e stereotipave lidhur me amësinë te femrat. Mënyra e tillë e prezantimit të femrave është shembull pozitiv, që mediat duhet ta ndjekin më shpesh, në luftën për barazinë në të gjitha fushat, në të cilat bëjnë pjesë edhe prezantimet për gjininë.

Siç u theksua më lartë, emisioni “Tungjatjeta Maqedoni” në pjesën më të madhe bazohet në paraqitje telefonike të shikuesve dhe anketat e qytetarëve në terren, më shpesh për ngjarjet aktuale-politike në vend, por edhe për temat tjera nga jeta e përditshme dhe religjioni. Anketat me qytetarët në terren ndahen në dy pjesë. Njëra është transmetuar në fillim të pothuajse çdo emision dhe është në lidhje me çështjet e jetës së përditshme të qytetarëve (mbipopullimi i Shkupit, puna, pozita e zjarrfikësve etj).

Anketa tjetër është në gjysmën e dytë të emisionit dhe për temë ka çështje aktuale ditore-politike që përkon me një prej temave për të cilën debatohet me shikuesit që inkuadrohen përmes telefonit (kontesti me emrin, politikat qeveritare dhe zgjidhjet kadrovike etj). Këto tërësi tematike janë krijuar nga dy gazetarë, nga të cilët njëri është i ngarkuar për anketat në terren, ndërsa tjetri (i cili njëherazi edhe redaktor i programit mëngjesor) është i ngarkuar për diskutimet me shikuesit e inkuadruar në studion, përmes linjës telefonike.

Për pjesën me temat si: ushqimi i shëndoshë dhe shëndeti, rrëfime interesante për njerëz ose vende nëpër botë etj) si dhe për informata (proгноza e kohës dhe gjendja e rrugëve) është e ngarkuar një udhëheqëse.

Është interesant se gjatë paraqitjes telefonike të shikuesve/eve meshkujt si bashkëbisedues janë rregullisht më aktivë se femrat në lidhje me çështjet politike, gjë që nuk varet nga mediat por nga interesimi i shikuesve për temën e caktuar. Nga ana tjetër, edhe në anketat gazetareske ka dyfish më shumë meshkuj (35 meshkuj kundruall 18 femrave). Këto kronika i realizon vetë media, përkatësisht gazetari e ka përgjegjësinë për zgjedhje të të anketuarve, kështu që mund të sigurojë përgjigje nga më shumë grupe qytetarësh. Mungesa e vetëdijes për rëndësinë e paraqitjes së mendimeve në lidhje me çështjet politike në vend, edhe të qytetarëve edhe të qytetareve flet për nivelin e ulët të të kuptuarit të barazisë gjinore në shoqërinë dhe në televizion.

### **Paraqitja dhe prezantimi:**

Në emisionin, nuk i jepet rëndësi dukjes fizike të udhëheqëseve dhe bashkëbisedueseve, megjithëse ndajnë informata për dobësim, por më shumë të kuptuar në aspekt shëndetësor. Dominon qëndrimi tradicional ndaj roleve gjinore dhe ndaj prezantimit dhe paraqitjes së femrave.

### **Konkluzion:**

Në edicionet e analizuara të emisionit mëngjesor në TV Kanal 5 "Tungjatjeta Maqedoni", aspekti gjinor i përpunimit të temave është rrallë i pranishëm, e kur do të paraqitet - pozita më shpesh është tradicionale dhe konservative. Pritet që femra t'i respektojë skemat patriarkale të sjelljes – e urtë, e qetë, pa të drejtë të kritikojë, dhe

zakonisht fajtores për diçka (p.sh: mbipopullimi i Shkupit). Përfaqësimi i femrave ndërmjet shikuesve/eve të cilat marrin pjesë në debat nuk është diçka mbi të cilën Televizioni mund të ndikojë, por mund të bëjë përpjekje që zëri i femrës të jetë i përfaqësuar barazisht në anketat, ndërsa gazetarët/et mund të kenë kujdes në përdorimin e gjinisë gramatikore femërore atëherë kur i përfaqësojnë profesionet e femrave. Shembulli i vetëm për paraqitje pozitive të fermës si person i cili është i aftë të jetë aktiv njëjtë edhe në sferën e privatësisë (nënë) edhe në sferën e shoqërores (autore e librit) del nga bashkëbiseduesja.

### Të dhënat e përgjithshme

**Ekzemplari për analizë:**

Emisioni mëngjesor „Ja sakam Makedonija (E dua Maqedoninë)“, edicioni nga 4, 10, 16, 22, 28 maj 2018.




**Zhanri:**

Programi informativ-zbavitës (Fotografia 33).

**Tema:**

- |  |                            |
|--|----------------------------|
| - Tema aktuale shoqërore-politike dhe sociale, | - Jeta në mjediset rurale, |
| - Shëndeti,                                    | - Krijimet e zejtarisë,    |
| - Kultura/arti,                                | - Të ushqyerit/gatimi,     |
| - Religjioni,                                  | - Sukseset e të rinjve,    |
| - Sporti,                                      | - Muzika,                  |
|  | - Kuriozitete etj.         |



Foto 33: Struktura emisionëve sipas funksionit të programeve (Sitel):



### Mënyra e përpunimit:


Raporte, intervista (drejtpërdrejt ose të incizuara), kontakti i drejtpërdrejtë telefonik me shikues, reportazhe, info-servis, emisione dokumentare.

### GJINIA NË „JA SAKAM MAKEDONIJA (E DUA MAQEDONINË)“



Në pesë edicionet e analizuara të „E dua Maqedoninë, ka gjithsej 117 bashkëbisedues/e – një pjesë janë mysafirë në studion ose bashkëbisedues/e në kronikat e incizuara, e një pjesë janë shikuese që debatojnë në pjesën konstatuese të titulluar si "Në rend dite" (Fotografia 36). Nga 44 bashkëbisedues/e në studion ose në kronikat, 28 janë meshkuj, dhe 16 femra. Katër femra dhe 5 meshkuj janë në moshë nga 18 deri në 30 vjet, 6 femra dhe 13 meshkuj hyjnë në kategorinë më të moshuar nga 31 deri 45 vjet, ndërsa 6 femra dhe 10 meshkuj janë mbi 45 vjet. Nga 73 teleshikues, 29 janë meshkuj, 44 femra.

Fotografia 36



Bashkëbisedueset paraqiten në funksion të përpunuesve të stolisë dhe sendeve dekoruese, eksperteve, dokoreshave, profesoreshave, nënave të vetme, farmaceutëve, historianeve etj., ndërsa temat në të cilat janë konsultuar njohuritë e tyre janë përpunimi i stolisë, çantave dhe sendeve tjera, shëndeti, jeta e femrave rurale etj. Meshkujt paraqiten në role të sportistëve, gazetarëve, studentëve, aktivistëve, drejtorëve, drejtuesve, babait të vetëm, prijësit fetar etj, ndërsa flasin për shëndetin, sportin, rekreacionin, kulturën, ushqimin, sfidat e baballarëve të vetëm, ngjarjet aktuale në shtet etj.

**Gjuha:**

Në emisionin mëngjesor „E dua Maqedoninë“ në TV Sitel, udhëheqësit/et dhe gazetarët/et më shpesh përdorin fjalim neutral gjinor dhe ndonjëherë fjalim i cili është afirmativ ndaj barazisë gjinore. Profesionet e bashkëbiseduesve në emisionin mëngjesor shpesh janë në gjininë mashkullore – argjendar, etnolog, kurator, nutricionist, nikoqir etj., megjithëse ka shembuj të tërësive tematike ku gazetarët/et, përmes gjuhës e cila është afirmative ndaj barazisë gjinore, përdorin gjininë mashkullore për profesionet e bashkëbiseduesve – kreative, profesoreshë, eksperte, këngëtare tj.

**Shembuj:**

Me analizën janë përfshirë gjithsej 59 njësi tematike nga të cilat tetë janë të lidhura me gjininë. Më 4 maj në studion mysafirë janë dy femra, Jeliz Andieva-Abduramanova dhe Dijana Stojanović, me të cilat u bisedua për një hulumtim për gjendjen e femrave në mjediset rurale, në të cilin Stojanović mori pjesë si eksperte kryesore, ndërsa Abdieva – Abduramanova flet për përvojën e saj personale si femër e cila rrjedh nga mjedisi rural. Temat e tilla është me rëndësi që të aktualizohen në mediat për shkak të nevojës për t’u dëgjuar edhe zëri i femrave rurale, që janë marginalizuar në shoqërinë. Jeliz Abdieva-Abduramanova flet për dallimet ndërmjet obligimeve dhe shprehive ditore të vajzave dhe grave që jetojnë në mjedis urban dhe rural, përditëshmëria e rëndë e vajzave që duhet të punojnë në fushë, të vjelin duhan dhe të socializohen nëpër shtëpitë. Flitet edhe për pavarësinë financiare të femrave, socializimin e tyre që dallon në mënyrë drastike nga socializimi i femrave në mjediset urbane dhe për mjediset publike që nuk janë të arritshme për femrat. Theksohen edhe ndryshime pozitive që kanë lënë gjurmë, siç është arsimi i mesëm i detyrueshëm i cili kontribuon për mobilitet më të madhe dhe socializim më të madh të femrave rurale. Kjo bisedë paraqet shembull pozitiv për aktualizimin e temave gjinore relevante dhe është e rëndësishme për eksponim në publik të femrave të suksesshme që rrjedhin nga mjediset rurale. Në disa raste (më shpesh në komunikimin ndërmjet udhëheqësve/eve), vërehet qasja patriarkale ndaj roleve gjinore, veçanërisht në martesë. Gjegjësisht, më 10 maj, emisioni fillon zakonisht me bisedë ndërmjet udhëheqësve, derisa përgatisin kafe dhe njëkohësisht bisedojnë për raportet ndërmjet

nuseve dhe vjehrrave, sepse nëse nuset dhe vjehrrat jetojnë bashkë, "respekti i ndërsjellë ndërmjet të dyjave në një shtëpi është gjëja më e nevojshme" dhe se është më mirë "një nikoqire një shtëpi. Megjithatë, kur është patjetër të jetohet bashkë, duhet patjetër të gjendet edhe mënyrë për të pasur mirëkuptim".

Më 10 maj, është transmetuar edhe kronika me tematika sociale, për babanë e vetëm Sabahko Hasiq dhe bijën e tij që kanë nevojë për donacion dhe ndihmë sociale. Me rëndësi, në aspektin gjinor, në rastin e dhënë, është që burri është paraqitur në aspekt të rolit të tij të babait i cili vetë kujdeset për fëmijën e vet në rrethana të vështira. Duke pasur parasysh se sipas të dhënave statistikore, në shtet, numër i vogël i familjeve me një prind përbëhen nga babai dhe fëmija, kjo kronikë është me rëndësi në aspekt social, kështu që u jepet rëndësi më të madhe mediatike këtyre familjeve.

Në edicionin nga 16 maj është transmetuar kronikë për shkollën e parë për femra në Prilep nga shekulli 19. Në pjesën hyrëse udhëheqësja në studion flet për atë se deri atëherë fëmijët femra nuk kanë pasur të drejtë të shkojnë në shkollë, dhe për rëndësinë që secili të ketë qasje në arsim. Kronika është kushtuar kryesisht galerisë së hapur dhe bisedës me kuratoren Mimoza Hristoska, si dhe për pasurinë kishtare në qytet.

Pas kësaj vijon kronika me titull "Pogaçja e gjyshes - e butë si shpirti dhe shumë dekoruese". Pjesa hyrëse dhe kronika përmbajnë stereotipa, me atë që u urojnë amvisave të cilat e përgatisin sofrën për kremtimin e Shën Spases (17 maj), ndërsa në kronikën femrën e paraqesin në kuzhinë si amvise e cila duhet t'i përgatisë ushqimet për kremtimin.

Në edicionin e njëjtë, në studion mysafire është edhe këngëtarja Mijata, e cila e promovon spotin për këngën e saj të re „Amvisja“. Kjo është edhe një bisedë në të cilën paraqitet edhe qasja pozitive në rolet gjinore - para së gjithash përmes përgjigjes së mysafires. Pra, e pyetur për frymëzimin për këngën, Mijata sqaron për kremtimin e saj, për zakonet e prindërve të saj, për nënën dhe për shoqen e saj kur kanë përgatitur ushqim për kremtimin, duke e përshkruar rolin tradicional të amvisës kështu:

*„Ajo veshje e brendshme të mos lahet, lecat e kuzhinës të mos lahen, kush ka thurur me grep, si ka qenë krahasimi, kanë garuar, pastaj mua më kthehet filmi, e di e edhe nëna*



*ime punonte dhe përgatiste njëjtë. Dhe, për shembull në kohën tonë për maskenball nuk kishte ku të blihen xhybe, dhe gjithë natën do të fillojë të qëndisë etj. Of bërtita, sikur të kisha qenë unë amvise në atë kohë, do të çmendesha! Nuk kishte mundësi të përballohen ato gjëra...Do të thotë kjo ka qenë një garë psikopatike, kështu që për amviset nga gjenerata e vjetër, të them për nënat, tezet tona etj, çfarë psikozë kanë pasur ato, ndoshta ne nuk jemi të vetëdijshme. Më kujtohet si fëmijë, as nuk dija se si vinin veshjet. Paloseshin, rregulloheshin. Kur shkova në Amerikë, shkova në internat të jetoj, të shikosh se si është ai proces, të cilin më tutje duhet edhe ti ta implementosh si amvise, u vetëdijesova dhe fillova ta vlerësoj. Dhe tani unë me gjithë dinamikën time dhe gjithë jetën time, kuptova se nuk ka mundësi që ai model i amvisërisë para 30-40 vitesh të implementohet. Dhe disi u krijua kjo këngë, fillet, frymëzimin e ka pikërisht nga ajo kohë. Megjithatë doli si mbrojtje e jona, sikur të sqarohet një ode, dëgjoni jeta është shumë më e bukur sesa të palosim dhe të hekurosim dhe të jemi robëresha...“.*

Njëra prej udhëheqëseve ia kujton mysafires se ka qenë e para e cila ka folur publikisht për dhënie gjë publikisht dhe vështirësitë me peshën e tepërt, por parashtrohet edhe pyetja cili stereotip paraqitet në intervistën me femra - si arrijnë të kombinohen roli i saj si person i angazhuar profesional me rolin e nënës. Në edicionin më 28 maj, përsëri ekipi i gazetarisë së emisionit mëngjesor “E dua Maqedoninë” përpunon temë në të cilën është përfshirë grupi i marginalizuar në shoqërinë, ekipi me autizëm dhe prindërit e tyre. Në rastin e dhënë bëhet fjalë për Natalija Angelius, nënë e vetme e tre fëmijëve nga të cilat njëri është diagnostifikuar çrregullim në kuadër të spektrit autist. Gazetarja hap çështje të rëndësishme për publikun për paragjykimet në shoqëri ndaj lëtyre fëmijëve, për përditshmërinë e prindërve të tyre, si dhe për vështirësitë me të cilat ballafaqohen.

Ditën e njëjtë, në segmentin ku inkuadrohen shkues me qëndrimet e tyre, është caktuar temë e cila është shumë e rëndësishme në aspektin gjinor, veçanërisht për autonominë trupore të femrave. Tema për debatin vijon – „Versioni i punës i ligjit për abortim është gati“. Çështja fillimisht është përpunuar përmes tekstit

gazetaresk në portalin e TV Sitel në pjesën e shëndetësisë. Udhëheqësja i inkuadron shikuesit në emision duke lexuar pasuse nga artikulli në të cilat janë cekur ndryshime të parapara të ligjit për abort. Pas kësaj, ajo u lë hapësirë shikuesve për ta shprehur mendimin e tyre. Ndërmjet telefonimeve të shikuesve, udhëheqësja tenton ta përpunojë temën nga ana e babait në rastin kur miratohet vendimi për abort, për ta hapur çështjen e shëndetit të femrës dhe çfarë përmban vendimi për abort. Shikuesit kanë mendime të kundërta, nga të cilat shumica janë konservativ dhe e konsiderojnë abortin si vrasje, ndërsa disa e konsiderojnë si temë jo aq e rëndësishme për debat. Udhëheqësja tenton të promovojë barazi gjinore si dhe të drejtë të zgjedhjes së femrës për të vendosur për trupin e vet, por nuk gjen interesim të madh nga shikuesit. Pikërisht pozicionim i tillë i teleshikuesve, tregon se sa është e rëndësishme që çështjet gjinore të hapen në emisione që targetojnë njerëz të kategorive të ndryshme të pleqërisë dhe strukturave sociale.

#### **Paraqitja dhe prezantimi:**

Në emisionin mëngjesor „E dua Maqedoninë“ nuk i jepet rëndësi dukjes fizike as edhe udhëheqëses as edhe bashkëbiseduesve në studio.

#### **Konkluzion:**

Nga edicionet e analizuar të emisionit mëngjesor „E dua Maqedoninë“ dhe nga temat që përpunohen, shihet një dualitet i caktuar në qëndrimin ndaj çështjeve gjinore. Nga njëra anë, hapen çështje që janë të rëndësishme për barazinë e femrave dhe meshkujve (ndryshimet e ligjit për abort, prindërit e vetëm – dhe meshkuj dhe femra), ndërsa nga ana tjetër qarkullon qasja tradicionale, konservative (veçanërisht përmes bisedimeve të palidhura ndërmjet udhëheqësve dhe udhëheqësit ose përmes zgjedhjes së çështjeve të profiluara gjinore për bashkëbiseduesit) vërehen kuptime stereotipe të roleve gjinore të nënës, bashkëshortes, bashkëshortit.



### Të dhëna të përgjithshme

#### **Ekzemplar për analizë:**

Emisioni mëngjesor „Utrinska na Telma”, edicioni nga 4, 10, 16, 22, 28 maj 2018.

#### **Zhanri:**


Programi zbavitës-informativ (Fotografia 37).



#### **Temat:**

- Informata,
- Kulturë dhe art (film, literaturë, teatër, muzikë etj),
- Shëndeti,
- Religjioni,
- Të qenët prind dhe kujdesi për fëmijë,
- Programi për fëmijë,
- Gatimi,
- Arsimi,
- Sporti,
- Hortikulturë etj.


Foto 37: Struktura emisionëve sipas funksionit të proi




### Mënyra e përpunimit:

Intervistë (më shpesh në studion), dialogu ndërmjet udhëheqësve/eve, program i specializuar informativ, dokumentar-zbavitës, zbavitës-dokumentar, program dokumentar, info-servis, lojëra.

### Gjinia në „Utrinska na Telma“



udhëheqëse të veçantë – meteorolog, ndërsa udhëheqësja ka dhe „0m+“ segmenti për udhëheqës. Udhëheqës ka në segmentin për fëmijë „Lart poshtë të gjithë jemi të barabartë“, në "Telma alternativa" dhe në segmentin për përgjigje të pyetjeve nga shikuesit përmes rrjeteve sociale, në lidhje me stilin e jetës. Në emisionet e analizuar paraqiten gjithsej 5 gazetarë dhe 4 gazetare (Fotografia 38).




Ekipin udhëheqës, të cekur në pjesën e fundit të edicionit, e përbëjnë dy meshkuj – redaktorë përgjegjës të Televizionit dhe të redaksisë zbavitëse (Fotografia 39).

Numri i përgjithshëm i bashkëbiseduesve dhe bashkëbisedueseve në tërësitë tematike është 121 persona, nga të cilat 49 janë meshkuj, ndërsa 72 femra. Si bashkëbisedues/e në intervistat paraqiten 58 persona (32 meshkuj dhe 26 femra), dhe ka 63 persona që paraqiten në telefon me pyetje në segmente të ndryshme nga

„Utrinska Telma“ ose që të marrin pjesë në lojën shpërblyese, nga të cilat 17 janë meshkuj dhe 46 femra (Fotografia 40).

Bashkëbiseduesit shpesh paraqiten dhe prezantohen si muzikantë, përfaqësues të Qendrës për menaxhim me kriza, jutjuberë, mjekë dhe menaxherë të evenimenteve, si dhe profesorë, sportistë, drejtorë dhe shkrimtarë. Bashkëbisedueset, më shpesh janë në rolin e mjekeve, përfaqësueseve të Lidhjes Auto-moto të Maqedonisë, studenteve, nënave, drejtoreshave dhe eksperteve. Më rrallë paraqiten si modele, përkthyes dhe aktiviste.

Grupi i moshës së rritur me numër më të madhe të bashkëbiseduesve është ai nga 31 deri 45 vjet (12 janë meshkuj, ndërsa 8 janë femra), ndërsa nën 18 vjet ka 5 fëmijë (4 djem dhe 1 vajzë).



## **Gjuha:**

E dukshme për këtë media është ajo që udhëheqësit dhe udhëheqëset më shumë përdorin gjuhë të verbër gjinore gjatë prezantimit të profesioneve të femrave, sesa me gjuhë e cila është afirmative ndaj barazisë gjinore. Rezultatet e tilla e tregojnë nevojën për sensitivitet gjinor në aspekt të gjuhës që përdoret në tërësi tematike, gjë që do të thotë shmangie të gjinisë gramatikore mashkullore gjatë prezantimit të profesioneve të bashkëbiseduesve. Në atë mënyrë, do të hapet mundësia që t'u jepet rëndësi femrave në diskursin publik, si dhe në profesionet, veçanërisht në ato të cilat janë pranuar shoqërisht si meshkuj stereotip. Shembull interesant dhe më pak kontradiktor është ai që personi i cili e udhëheq prognozën kohore është prezantuar si meteorolog, e jo si prezantuese gjë që është pozitive. Por, duhet të mendohet për prezantimin e profesionit në gjini mashkullore, duke pasur parasysh faktin se procesi i fjalëformimit në gjuhën maqedonase, si dhe në të gjitha gjuhët tjera, është i vazhdueshëm edhe në atë kontekst, për llojin e tillë të fjalëve mund të ndiqet shembulli i gjuhëve tjera sllave. Për shembull, në gjuhën serbe, boshnjake dhe kroate (dhe mediat haset nocioni "meteorologe".

## **Shembuj:**

Në shembullin e analizuar, janë përfshirë gjithsej 62 tërësi tematike, nga të cilat në 10 mund të vërehen tema gjinore/aspekt gjinor.

Tërësitë tematike me tematikë gjinore janë vendosur në secilën ditë të analizuar.

Më 28 maj, është transmetuar një fragment nga emisioni për fëmijë „Lart poshtë të gjithë jemi të barabartë“ ku me tre djem dhe një vajzë flitet për vizitën e tyre në Markov Manastir. Njëri prej djemve rrëfen për ngjarjen interesante nga vizita, kur bashkënxënësit e tij kanë parë një shtëpizë të braktisur. Në shtëpizën ka qenë errët, janë parë dritare të thyera. Djali rrëfen se bashkënxënësit e tij brenda kanë parë „*përbindësh me sy të kuq*“, dhe se kanë dëshmi për atë – screenshot në celular. Derisa udhëheqësi e pyet djalin për informata plotësuese, një djalë i pranishëm në studio thotë "*ndoshta ka ardhur atje ndonjë mësuese*". Udhëheqësi thotë: „*...ndonjë mësuese me sy të kuq ju ka përgjuar*“. Megjithëse deklarata e tillë është shaka nga

fëmijët, ajo është mbështetur nga ana e udhëheqësit, me çka në instancë të fundit profesioni i mësuesit/es është i lidhur drejtpërdrejt me gjininë femërore dhe është vënë në rolin e negativit. Meqë ky emision për fëmijë ka funksion zbatimës, por edhe edukativ, paragjykimet e tilla, qoftë të shprehura në formë të shakasë. ndikojnë në zhvillimin dhe qëndrimet e fëmijëve nga mosha e tyre më të hershme.

Ditën e njëjtë, kah fundi i emisionit, është transmetuar intervistë me organizuesin e evenimentit "OFFEST" dhe me fëmijë nga artistët që marrin pjesë në festivalin. Në bisedën, organizuesi i evenimentit flet për artistët që do të interpretojnë, dhe e përmend Oumou Sangare (Umu Sangare), muzikante nga Afrika për të cilën thotë se është „luftëtare“ për të drejtat e femrave në Mali dhe Afrikë. Duke rrëfyer për të, thotë se ajo është edhe "sipërmarrëse" dhe merret me biznes me automjete. Meqë mysafirin e prezanton si sipërmarrës“, udhëheqësi ndërlihet dhe thotë se ajo është „biznismene“. Ky shembull e sjell në absurditet lajthitjen se gjinia gramatikore është gjuhë (e verbër) neutrale gjinore e cila gjithmonë i përfshin të dyja gjinitë (për shembull edhe gjatë prezantimit të profesioneve të femrave). Megjithëse qëllimi i mysafirit është që ta tregojë veçantinë e artistes, në kontekst të profesionit jostereotip, përdorimin e gabuar të gjinisë gramatikore të emrit me të cilin shënohet profesioni shkakton konfuzion edhe te udhëheqësi, i cili momentalisht mendon se bëhet fjalë për mashkull. Më tutje, mysafiri vazhdon të flasë për artisten në gjininë femërore. Udhëheqësi dhe udhëheqësja, megjithëse kanë mundësi për ta komentuar aktivizmin dhe profesionine saj i cili konsiderohet si jotipik në aspekt të gjinisë, ose të pyesin për numrin e artistëve që do të interpretojnë, vazhdojnë me bisedën e përgjithshme për evenimentin.

Më 22 maj, në emisionin mëngjesor është mysafirë është Renata Çaparoska, ish-mise dhe modele. Me të flitet për zgjedhjet për bukuri në të cilat ka marrë pjesë, planet e ardhshme, si dhe për perceptimet e saj për bukurinë e femrës. Në pjesën hyrëse për mysafiren, udhëheqësi thotë: „*Emisioni i sotëm „Utrinska në Telma“ është pasuruar, zbukuruar me një zonjë...*“ .Mënyra e tillë e prezantimit të mysafireve si zonja përsëritet disa herë në edicione të ndryshme të emisionit, me çka në aspektin stereotip theksohet feminiteti. Mysafires i parashtrohen pyetje për atë se çfarë janë

standardet e saj për bukurinë, perceptimet e saj për dietat dhe kirurgjinë estetike, por nuk i është dhënë vështrim gjinor temës, përkatësisht vallë perceptimet e tilla mund të jenë të ndryshme ose vallë si shoqëri i formon këto standarde. Qëndrimi i gazetares dhe gazetarit ndonjëherë është objektivizues, me atë që flet veçanërisht për bukurinë e jashtme të femrave, megjithëse mysafirja përmend se shpesh rol të madhe në zgjedhjen ka edhe intelektin. Gjithashtu, në fjalimin e udhëheqësit vërehet një paragjykim i caktuar ndaj kirurgjisë estetike me atë që disa herë potencon se korrigjimet duhet të jenë "në kufij mesatare". Është e dukshme rëndësia e potencuar që i jepet dukjes fizike, me atë që paraqiten fotografi nga zgjedhjet në të cilat ka marrë pjesë mysafirja, më tutje flitet për dukjen e saj fizike si dhe si duhet të jetë dukja fizike e femrave tjera. Megjithëse në bisedën nuk bëhet fjalë për seksualizmin e femrave, përsëri vërehet pasivizimi i tyre subtil, me atë që janë prezantuar vetëm përmes bukurisë së tyre, përmes së cilës përforcohen stereotipet në mënyrë plotësuese lidhur me zgjedhjet për bukurinë.

Tërësia e fundit tematike e kësaj dite, u është kushtuar fëmijëve dhe kujdesit prindëror, dhe është pjesë e segmentit „0m+“ – Shujta të shërbyera në mënyrë të përsosur për nazeqarët e vegjël. Në emisionin janë ftuar dy mysafire – nëna, të cilat në mënyrë kreative ua servojnë shujtat fëmijëve të tyre që t'i nxisin ato t'i hanë të gjitha përbërjet e nevojshme ushqyese. Përshtypja e parë e cila fitohet nga biseda është se qëndrimi ndaj roleve gjinore është tradicional, me atë që vazhdimisht flitet për nënat që duhet të kujdesen për ushqimin e fëmijëve. Megjithatë, udhëheqësja duke u drejtuar mysafirëve, potencon se ato janë realizuar në mënyrë profesionale, por kjo nuk paraqet pengesë për to për t'u kujdesur për ushqimin e fëmijëve të tyre. Në atë mënyrë, përveç prezantimit tradicional të femrave në rrethin e familjes, më saktësisht në kuzhinë, ajo i kushton vëmendje edhe angazhimit të tyre profesional edhe rolit jashtë kornizave të sferës private. Në fund të intervistës me mysafiret, ajo thotë:

*„Vazhdoni edhe më tutje ashtu, vërtetë jeni të shkëlqyer dhe shpresoj se do të motivojmë sot edhe nëna tjera, por edhe baballarë, të cilat i përgatisin shujtat për fëmijët e tyre...“* Si përgjigje, njëra prej mysafireve ndërlihet me deklaratën: *„Tanët kontribuojnë, apel për të baballarët tjerë që ta bëjnë atë për fëmijët e tyre sepse investimi në fëmijët tanë është diçka që asnjëherë nuk do të pushojë“.*



Theksimi i rolit të baballarëve në kujdesin për fëmijët është një prej aspekteve kryesore në arritjen e barazisë gjinore. Kështu që theksohet rëndësia e ndarjes së obligimeve në shtëpinë dhe rreth fëmijëve, me çka dekonstruktohet paragjykimi ekzistues se këto obligime janë veçanërisht detyrë e femrave. Në këtë tërësi tematike, të dukshme janë hapat pozitive në prezantimin e femrave jashtë shtëpisë – në sferën profesionale, si dhe prezantimin e meshkujve në kuadër të shtëpisë, me atë edhe zgjerimin e kuptimeve të ngushta shoqërore për rolet gjinore.

Më 16 maj, në tërësinë tematike „Telma ambullanta“ – keratokonus (simptoma, diagnoza, trajtimi dhe shërimi), mysafirja doktoreshë thotë: *„Zhvillimi i sëmundjes mund të varet nga gjinia, nëse është femër e cila ka lindur ose jo, sepse hormonet gjatë shtatzënisë mund ta përshpejtojnë, të shkaktojnë zhvillim të shpejtë të sëmundjes...“*. Në këtë mënyrë ofrohen të dhëna të ndara gjinore për sëmundjen, gjë që konsiderohet si shembull pozitiv dhe është rekomandim në hulumtimet e gjinisë dhe medieeve në vitet e kaluara. Në sqarimin e shkaqeve për zhvillimin e sëmundjes, femrat janë prezantuar përmes rolit të tyre të amësisë, por në këtë rast, kjo nuk është prezantim i stereotipizuar sepse ndryshimet fizike që ndodhin te femrat në këto procese janë të rëndësishme për të kuptuarit e sëmundjes dhe parandalimin e mundshëm.

Shembull të kundërt ka në edicionin nga 10 maj, në pjesën të dedikuar për këshilla për problemet shëndetësore te shikuesit – „Telma ambullanta“ për alergjitë, rriqrat dhe melanoma e lëkurës. Mysafirja – specialiste duke folur për rëndësinë e vaksinimit të fëmijëve, thotë: *Diçka që do të dëshiroj të them, megjithëse sot nuk është tema, por ja do ta shfrytëzoj momentin, nënat doemos duhet të lexojnë pak më shumë për sëmundjet për të cilat vaksinohet fëmija“*. Me formulimin e tillë, bashkëbiseduesja, i paraqet femrat përmes rolit të amësisë, përkatësisht prindërisë, ndërsa burri-babai nuk është përmendur në këtë kontekst. Megjithatë, vendimi për shëndetin e fëmijës është përgjegjësi e të dy prindërve, e me theksimin e obligimit veçanërisht të nënës, përforcohet pabarazia gjinore në ndarjen e roleve dhe obligimeve gjinore në kuadër të shtëpisë dhe familjes.

Më vonë në edicionin e njëjtë, është transmetuar tërësi tematike – intervistë me tre maqedonas jutjuberë, në lidhje me „YTMKD SHOW – Youtube shou i parë në Maqedoni“. Përveç

promovimit të evenimentit, në intervistat flitet për zhvillimin e sferës së incizimit të videove për Youtube në vend. Gjatë bisedës, udhëheqësja i pyet tre jutjuberët nëse kanë femra që merren me atë, ku mysafirët përgjigjen se nuk ka sepse ka më shumë gjasa që të kenë turp, por apelojnë t'u bashkëngjiten vajza. Në këtë mënyrë, duke u nisur nga pritjet stereotipe për vajzat si të turpshme, futet aspekt gjinor në këtë temë, lidhur me gjininë dhe progresin teknologjik, gjë që sugjeron për hakmarrje gjinore edhe te udhëheqësja edhe te mysafirët. Në mënyrë plotësuese, është pozitiv shembulli i inkurajimit të vajzave që mendojnë që aktivizohen në këtë sferë, e cila te ne deri tani llogaritet për meshkuj.

Kah fundi i emisionit, është transmetuar edhe intervista me ish-alkoolistin, i cili flet për luftën me alkoolizmin dhe pasojat. Në intervistën, ai flet për mungesën e këshillimoreve, për alkoolizimin si problem sistemor, e njëkohësisht e sqaron edhe procesin e shërimit. Kah fundi i intervistës, mysafiri thotë se në shtet ekzistojnë afro 80.000 alkoolistë, ku udhëheqësja ndërlidhet me pyetjen: „*A dini përqindjen e femrave?*”. Mysafiri përgjigjet se nuk është shumë i sigurt në lidhje me të dhënat dhe shton: *“Mendoj se 4 ndaj 1 është tani, më parë ishte 7 ndaj 1, tani është diku 4 ndaj 1...”*. Pyetjet e tilla, për të dhënat a ndara gjinore për dukuri dhe probleme që ekzistojnë në shoqëri tregojnë për hakmarrje gjinore dhe distancim nga lidhjet stereotipe të problemit me alkoolizmin veçanërisht me meshkujt. Siç flasin edhe të dhënat, alkoolizmi paraqet problem edhe për femrat, dhe nga ato shkaqe është e nevojshme që ato të përfshihen në zgjidhjen sistemore të problemit dhe të ofrojnë ndihmë në procesin e shërbimit. Për këtë arsye, është pozitiv shembulli në të cilin udhëheqësja tenton që ta elaborojë temën më thellësisht, duke shtuar edhe aspektin gjinor.

Më 4 maj, janë transmetuar dy tërësi sistematike në të cilat është përfshirë problematika gjinore. E para është planifikuar si intervistë me futbollistin Darko Pançev, ku është e pranishme edhe bija e tij Maria. Qëllimi i intervistës është në fakt promovim i lojës shpërblyese të Snickers – „Njihe Ronaldon”. Në intervistën flitet edhe për rregullat për lojën shpërblyese, gjendjen në futbollin maqedonas dhe për aktivitetet e mysafirit në aspekt të karrierës së tij. Në fillim të intervistës përmendet se bashkëshortja e tij është pas kamerave, ndërsa ai është vendosur në qendër të vëmendjes. Gjatë bisedës,

udhëheqësja i drejtohet bijës së mysafirt, duke i thënë se është e hollë, dhe prandaj mund të hajë çokollatë. Në këtë mënyrë, në plan të parë paraqiten paragjykimet shoqërore për standardet për bukurinë që u imponohen femrave, në veçanti të lidhura me trupin e hollë të femrës. Më tutje, në videon promotive për lojën shpërblyese, duke e përshkruar Brazilin, Darko Pançev thotë se ai është vendi i femrave më të bukura. Në përgjithësi, kjo tërësi tematike ka mjaft paraqitje tradicionale dhe stereotipe të femrave. Në njërin skaj, bashkëshortja e Darko Pançev është paraqitur në hije, ndërsa bija është paraqitur sipas dukjes fizike, më saktësisht trupit të hollë. Skaji tjetër është potencimi i atraktivitetit të femrave braziliane, si adut i cili nuk ka lidhshmëri të madhe me qëllimin e lojës shpërblyese - "Njihe Ronaldo".

Tërësia e dytë tematike nga dita e njëjtë në të cilën paraqitet tematike gjinore është fragment nga emisioni për fëmijë „Lart posht të gjithë jemi të barabartë“ në të cilin flitet për zjarrëfikësit dhe profesionin e tyre të rrezikshëm. Në studio janë të pranishëm tre djem dhe një vajzë, ndërsa prezantohen informacione interesante për zjarrëfikësit. Udhëheqësi në fillim thotë se në emisionin e tij paraprak („Ej ti mbylli sytë“), gjysma e djemve kanë dashur të jenë policë, e gjysma - zjarrëfikës. Në atë mënyrë, prezanton të dhëna të ndara gjinore, megjithëse ato janë tradicionale në aspekt të stereotipave gjinore, përkatësisht profesionet e zgjedhura janë tradicionalisht për meshkuj. Më tutje, udhëheqësi fillon t'i pyesë fëmijët në studion çfarë dëshirojnë të jenë kur do të rriten, dhe i ndërpret me pyetjen se a ekzistojnë zjarrëfikëse - femra, ku fëmijët përgjigjen PO. Fjalimi i tij është afirmativ ndaj barazisë gjinore. Udhëheqësi e potencon prezencën e femrave në profesion i cili është i pranuar shoqërisht si për meshkuj, dhe në atë mënyrë zhvillohen pozitivisht qëndrimet dhe pikëpamjet e fëmijëve për të cilat është dedikuar emisioni. Përveç kësaj, ai përdor edhe gjini të drejtë gramatikore duke përdorur fjalën „zjarrëfikëse – femra“.

### **Paraqitja dhe prezantimi:**

Pamja fizike e udhëheqësve/udhëheqëseve dhe bashkëbiseduesve / bashkëbisedueseve nuk është potencuar, përveç në bisedën me ish misin në të cilën ekziston një dozë e caktuar e objektivizimit që është e pashmangshme duke pasur parasysh atë që flitet për zgjedhjet e bukurisë.

Në prezantimin e gjinisë në këtë emision, vërehet një shkallë e caktuar e vetëdijes në lidhje me aspektin gjinor të temave. Për temat e caktuara shëndetësore dhe profesionale janë ofruar të dhëna të ndara gjinore, si dhe dalje nga prezantimi tradicional dhe i stereotipizuar i femrave dhe meshkujve, përmes prezantimit të tyre në sferën profesionale dhe vendore në mënyrë të barabartë. Nga ana tjetër, në 2 kronika, femrat janë prezantuar në kuptimin tradicional, nëpërmjet pasivizimit të tyre në aspekt të pamjes dhe roleve familjare të nënës dhe bashkëshortes.

### **Konkluzioni:**

Në pesë edicionet e analizuar të majit në „Programi i mëngjesit në Telma“ vërehen qëndrimet dhe shkallët e ndryshme të vetëdijes në aspekt të tematikës gjinore që varen nga karakteri i temës e cila shtjellohet në secilën tërësi tematike. Ndërsa në një pjesë të tërësive tematike mund të vërehet qasja tradicionale, ose stereotipe, në një pjesë të tyre vërehet vetëdija e zhvilluar për aspektin gjinor të temave nga jeta e përditshme. Në mënyrë plotësuese, vërehet se edhe pse në shtjellimin e temave të caktuara mund të imponohet aspekti gjinor, redaksia vendos mos ta vë theksin në problematikën gjinore.

Pjesëmarrja e femrave dhe në kuadrin e gazetarëve dhe në mesin e bashkëbiseduesve / bashkëbisedueseve është e rëndësishme, ndërsa te lajmëruesit / lajmërueset ekzistojnë dyfish më tepër, që në një pjesë me siguri janë për shkak të angazhimit të tyre më të madh që të lajmërohen kur bëhet fjalë për shëndetin.

## Rekomandimet:

- ✓ Televizionet duhet në emisionet e mëngjesit të tentojnë t'i shtjellojnë çështjet gjinore ose të sigurojnë të dhëna relevante gjinore lidhur me temat e përditshme (për shembull, të dhënat statistikore të ndara gjinore ose informatat tjera që varen nga gjinia e personalitetit). Kjo është aq e rëndësishme, nëse merret parasysh se këto emisione kanë publik të llojlojshëm potencial.
- ✓ Temat që lidhen me sferën e privatësisë mos t'i lidhin, para se gjithash (ose madje edhe në raste të jashtëzakonshme) me femrat sepse ashtu i përforcojnë stereotipat dhe paragjykimet gjinore.
- ✓ Gazetarët t'u shmangen pyetjeve të profiluara gjinore (për shembull, vetëm femrat të pyeten se si i kombinojnë obligimet e jetës private dhe të jetës shoqërore).
- ✓ Gazetarët / gazetaret të zhvillojnë vetëdijen për atë se sa dhe përse është me rëndësi të shfrytëzohet gjinia gramatikore korrekte, veçanërisht të atyre emrave që shënojnë funksione, profesione, tituj dhe ngjashëm të femrave. Përdorimi i gjinisë gramatikore mashkullore në situatat e tilla nuk është neutrale gjinore, por e paraqet një mënyrë që të zvogëlohet rëndësia e pjesëmarrjes dhe dukshmëria e femrave në sferën publike.

## Biografite e autorëve/autoreve:

**Emilija Petreska-Kamenjarova** është magjistër i komunikimeve dhe gazetare e diplomuar. Ka punuar në radio, në televizion dhe në agjencinë e lajmeve para se të fillojë të punojë në trupin rregullator në vitin 2002. Ajo është udhëheqëse e Seksionit për të Drejtat e Njeriut dhe Arsimimit Mediatik pranë Sektorit të Punëve të Programit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Punon në çështjet e gjinive, lirisë së të shprehurit, gjuhës së urrejtjes, të drejtat e njeriut dhe standardet profesionale, qasjes te mediet për personat me aftësi të kufizuara të shqisave, zgjedhjet, arsimimit mediatik, etj. Është autore e teksteve për gjininë në mediet, gjuhën e urrejtjes, gjendjen me radiodifuzerët, onlajn mediet, gazetarinë qytetare. Ka mbajtur ligjërata/trajnime/ka qenë paneliste me temat: mediet dhe gjinitë/trupi i femrës, grupet gjinore të pakicave, gjuha e urrejtjes, e drejta e privatësisë, arsimimi mediatik, klientelizmi te mediet.

**Marina Trajkova** ka diplomuar në Institutin për Studime Gjinore pranë Fakultetit Filozofik të Universitetit „Shën Cirili dhe Metodi“ në Shkup. Para se të angazhohet në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ka punuar në sektorin joqeveritar, konkretisht në hulumtimet dhe projektet që kanë të bëjnë me çështjet gjinore dhe të drejtat e LGBTI-së. Në këtë moment është bashkëpunëtore në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në Seksionin për të Drejtat e Njeriut dhe Arsimimit Mediatik pranë Sektorit të Punëve të Programit. Punon në analizat dhe raportet lidhur me gjininë dhe orientimin seksual në mediet, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin në përmbajtjet mediatike, si dhe në fushën e arsimimit mediatik. Është autore e punimeve nga sfera e gjinive dhe medieve.

**Viktor Stojanov** është magjistër i së drejtës së pronësisë intelektuale dhe jurist i diplomuar në Fakultetin Juridik „Justiniani i

*Parë” nga Shkupi. Nga viti 2016 punon si bashkëpunëtor në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në Seksionin për të Drejtat e Njeriut dhe Arsimimit Mediatik pranë Sektorit të Punëve të Programit. Punon në projektet për arsimimin mediatik, hulumtimet për të rinjtë dhe mediet, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin, çështjet gjinore, mbikëqyrjen e zgjedhjeve, etj.*

**Teodora Ristovska** është magjistre e menaxhmentit të resurseve njerëzore dhe ka diplomuar në Fakultetin Filozofik të Institutit për Studime Gjinore. Ajo është bashkëpunëtoare në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në Seksionin e Identitetit Kulturor pranë Sektorit të Punëve të Programit. Punon në mbikëqyrjen e zbatimit të obligimeve ligjore lidhur me ruajtjen e identitetit kulturor, është përfshirë edhe në mbikëqyrjen e prezantimit mediatik gjatë kohës së proceseve zgjedhore, si dhe në aktivitete tjera. Mori pjesë në përpilimin e hulumtimeve për çështjet gjinore në programet e radiodifuzerëve në vitin 2015 dhe në vitin 2016.

**Nesrin Mahmut** diplomoi në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” - Shkup, drejtimi i shkencave politike. Nga viti 2011 punon si bashkëpunëtoare në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në Seksionin e Identitetit Kulturor pranë Sektorit të Punëve të Programit. Kryen punë dhe detyra në lidhje me nxitjen dhe ruajtjen e identitetit kulturor, merr pjesë në mbikëqyrjen mbi respektimin e konceptit të programit për të cilën u është lëshuar leja radiodifuzerëve, është përfshirë në mbikëqyrjen e prezantimit mediatik gjatë kohës së proceseve zgjedhore, dhe në aktivitete tjera.